

**UNIVERSITETI I EJL**

**ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ**

**SEE UNIVERSITY**



**Fakulteti i Juridik**

**Praven Fakultet**

**Law Faculty**

## **STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË**

### **PROGRAMI-E DREJTA PENALE**

#### **TEMA**

**“ZBATIMI I DËNIMIT ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË R.MAQEDONISË”**

**MENTORI:**

Prof. dr. Ismail Zejneli

**KANDIDATI:**

Berat Ajdini

Tetovë, 2019

*“Ju premtova se do t’iu tregoja një barsaletë. Vdekja më ka çliruar. Kjo është barsaleta më e madhe. Tjetra është se unë nuk jam Patrick Bryan dhe ju tashmë nuk mund ta ndaloni këtë ekzekutim.*

*Kaq kisha.*

***Patrick Bryan Night, i dënuar me vrasje të dyfishtë dhe u dënua me vdekje në 26 Qershor 2007***

## **PËRMBAJTJA E PUNIMIT**

### **“ZBATIMI I DËNIMIT ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË R.MAQEDONISË”**

HYRJE	7
METODOLOGJIA E PUNIMIT	8
ARSYESHMËRIA E PUNIMIT	8
QËLLIMET E HULUMTIMIT	9
HIPOTEZAT	10
KAPITULLI I PARË	11
1. NOCIONI I SISTEMIT TË DËNIMEVE	11
1.2 Evolucion i dënimit	13
1.3 Teoritë për qëllimin e dënimit	17
1.3.1 Teoritë absolute për dënimin adekuat	20
1.3.2 Teoria relative për dënimin	22
1.3.3 Teoria integrative për dënimin	22
1.4 Qëllimi i dënimit në KPM-së	24
KAPITULLI I DYTË	26
2.1 KONVENTAT NDËRKOMBETARE MBI EKZEKUTIMIN E DËNIMIT ME BURG	26
2.2 Ligjet vendore për ekzekutimin e dënimit me burg	29
2.3 Rregullat minimale standarde të OKB-së, për trajtimin e të burgosurve	33
2.4 Konventa kundër torturës	36
Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke e përfshirë edhe lirinë	37
2.5 Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i R.Maqedonisë	42
KAPITULLI I TRETË	45
3.1 POZITA E PERSONAVE TË DËNUAR ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË BURGUN E IDRIZOVËS	45
3.1.1 Fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg të përjetshëm	50
3.2 Pranimi i personave të dënuar	51
3.3 Të drejtat e personave të dënuar me burgim të përjetshëm	54
3.3.1 E drejta për ankesa dhe ndihmë juridike	58

3.3.2 E drejta e këmbimit të letrave	58
3.3.3 E drejta për pranimin e pakove	59
3.3.4 E drejta për vizita dhe kontrollime mjeksore	60
3.3.5 E drejta për korrespondenca me avokatin	61
3.4 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të përjetshëm	62
KAPITULLI I KATËRT	63
Tabela nr.1 Situata e dënimit me burgim të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2013-2017	64
Tabela nr.2 Situata e dënimeve në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2013-2017	64
Tabela nr.3 Situata e dënimeve në Republikën e Maqedonisë në periudhën 2013 -2017	66
4.1 Struktura e personave të dënuar	66
Tabela nr.4 Struktura e personave të dënuar me burgim të përjetshëm	66
4.2 Mosha e personave të dënuar	67
Tabela nr.5 Mosha e personave të dënuar me burgim të përjetshëm	67
4.3 Gjinia e personave të dënuar	68
Tabela nr.6 Gjinia e personave të dënuar	68
Gjinia e personave të dënuar në Burgun e Idrizovës 2015-2017	68
4.4 Numri i personave të dënuar sipas llojit të veprave penale	69
Tabela nr.7 Numri i personave të dënuar me burg të përjetshëm sipas llojit të veprave penale	69
Numri gjithsej i personave të dënuar sipas masave të dënimit, për periudhën 2010-2012	70
Numri i personave të dënuar sipas masave të dënimit për vepra penale kundër personit, për periudhën 2010-2012	70
Numri i personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas masave të dënimit, për periudhën 2010-2012	71
4.5 Metodatat e analizës së të dhënave	72
ANKETA	72
Tabela 1. Numri i të anketuarve reth burgimit të përjetshëm si fenomen në Republikën e Maqedonisë.	73
Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm i të anketuarve	73

Tabela 2. Grup mosha e të anketuarve	74
Grafikoni 2. Grup mosha e të anketuarve	74
Tabela 3. Kategoritë e të anketuarve	74
Grafikoni 3. Kategoritë e të anketuarve	75
Tabela 4. Vendbanimi i të anketuarve	75
Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarve	75
Tabela nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?	76
Grafikoni nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?	76
Tabela nr.6 A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?	77
Grafiku nr.6 A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?	77
Tabela nr.7 A e mbështetni edhe ju parimin ‘jeta është jetë’?	78
Grafikoni nr.7 A e mbështetni edhe ju parimin ‘jeta është jetë’?	79
Tabela nr.8 A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.	80
Grafikoni nr.8 A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.	80
Tabela nr.9 A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t’u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimimit, formimit profesional, punësimin, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.	81

Grafikoni nr.9 A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.	81
❖ RAST STUDIMI KONKRET I DËNUAR NË BURGUN E IDRIZOVËS ME BURG TË PËRJETSHËM	82
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	83
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	86
Burime shtesë	87
Ligje	88

## HYRJE

Kërkimi me Temë “Zbatimi i Dënimit me Burgim të përjetshëm në R.Maqedonisë do të përpiqem të jap një pasqyrë konkrete të përmasave dhe thellësisë të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm duke përfshirë të gjithë territorin e R.Maqedonisë. Kjo do të arrihet përmes identifikimit të të ndodhjes së veprave të ndryshme penale që u shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm, format më të shpeshta të veprave penale që kryen dhe që u shqiptohet ky lloj dënimi, kategoritë e veprave penale që u shqiptohet dënimi me burgim të përjetshëm, mënyrat dhe kushtet e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm, mënyrat dhe kushtet e zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm, si zbatohet ky lloj dënimi ,a zbatohet në përpikshmëri ky lloj dënimi, a zbatohet në mënyrë të drejtë dhe a zbatohet për të gjithë veprat penale a jo, sa është kjo humane dhe e drejtë ky lloj dënimi, si ndikon ky lloj dënimi në aspektin psikologjik sociologjik fizik etj.

Studimi do të rrekë të trajtojë teoritikisht nocionin e dënimit me burgim të përjetshëm, ofrimin nga ana teorike të një listë të kategorive të veprave të ndryshme penale që u shqiptohet ky lloj dënimi, kategorizimin e tyre për nga format, motivet, shkaqet të cilëve veprave u shqiptohet ky lloj dënimi. Ky lloj hulumtimi do të përfshijë dhe perceptimin e qytetarëve personave të ndryshëm në institucione shtetërore dhe gjyqësore çka mendojnë për dënimin me burgim të përjetshëm, çka mendojnë për zbatimin e këtij lloj dënimi dhe çka mendojnë a zbatohet ky lloj dënimi për të gjithë veprat penale a jo, çfarë perceptimi kanë qytetarët për këtë lloj dënimi, çfarë perceptimi kanë për zbatimin e tij çka mendojnë qytetarët a është i drejtë dhe human ky lloj dënimi.

Zbatimi i dënimit me burgim të përjetshëm është një proces mjaft i ndërlikuar, shumë kompleks duke pasur parasysh dimensionin ligjor, aspektin social, psikologjik, ekonomik ku një proces i tillë i përfshin. Për rrjedhojë trajtimi i” Zbatimi i dënimit me burgim të përjetshëm në R.Maqedonisë” ka shkallë të konsiderueshme vështirësie duke pasur parasysh perspektivën multidisiplinore të intergruar që hulumtuesi do ta përdorë andaj studimi do të përpiqet të jetë konkret i treguar qartë dhe me fokus të ngushtë studimi. Kjo do të bëjë që studimi të evitohet sadopak shkallën e vështirësisë të jetë origjinal dhe ndihmues në dhënien e rekomandimeve të mirëinformuara që do të mund të ndikojnë në studimin në fjalë.

## **METODOLOGJIA E PUNIMIT**

Nisur nga perspektiva multidisiplinore e trajtimit të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në Maqedoni metodologjia që do të përdoret për të realizuar hulumtimin e propozuar që do të jetë e pasur me mjetet e mbledhjes së të dhënave si dhe do të shfrytëzojë disa metoda teknike. Këto metoda duhet të jenë të qarta, të sakta dhe si të tilla të pasqyrojnë perspektivën multidisiplinore të qasjes hulumtuese. Gjatë këtij hulumtimi do të përdorë të menduarin deduktiv përkundër atij induktiv duke pasur parasysh se në trajtimin e fenomeneve ligjore përdoret më së shumti ky lloj mendimi. *Pjesa tjetër rreth metodologjisë së punimit më së shumti është shpërndarë në kapitullin e veçantë Metodologjia e hulumtimit ku atje do të theksojmë interpretimin e të dhënave dhe analizën e statistikave.*

## **ARSYESHMËRIA E PUNIMIT**

Hulumtimi i propozuar mbart në vete rëndësinë e vet në lidhje me trajtimin e zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në Maqedoni. Ky hulumtim do të kontribuojë në të kuptuarit më të mirë dhe më të qartë dhe të saktë të zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në Maqedoni si dhe për të kuptuarit për dënim me burgim të përjetshëm, kategorimin e veprave penale të përcaktuar me ligj për të cilat shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm, motivet, shkaqet arsyet e kryesve të veprave të rënda penale për të cilat shqiptohet ky lloj dënimi, tolerancën qytetare dhe atë ligjore, si dhe për të kuptuarit e shqiptimit dhe zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm si dhe për të kuptuarit e nocioneve dhe çështjeve kyçe të këtij studimi.

Përfundimet e hulumtimit do të jenë me rëndësi për një seri institucionesh dhe profesionalistët e disiplinave të ndryshme, ku do të jetë e rëndësishme për institucionet e ligjit që të kuptojmë më mirë përmasat dhe identifikimin e vakumit ligjor që mund të ekzistojë në trajtimin e këtij studimi ndërsa për institucionet tjera të cilët kanë një ndikim në luftimin, parandalimin dhe reduktimin e veprave të rënda penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm që të kuptojnë për shkaqet motivet arsyet pse i kanë kryer personat e tillë veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi si dhe të gjejnë mënyra të reja në parandalimin dhe reduktimin e veprave të rënda penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm.

Gjithashtu rëndësia e këtij hulumtimi lidhet edhe me ndikimin e shoqërisë si një ngarkesë morale që veprat e tilla penale të mos kryhen për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm dhe



kështu të mos zbatohet ky lloj dënimi dhe kështu shoqëria deri-diku mund të ndikojë në parandalimin dhe reduktimin veprave të rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.

*Poashtu ky hulumtim ka për qëllim të japë kontributin e vet pozitiv në lidhje me luftimin, parandalimin dhe reduktimin e veprave të rënda penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm si dhe për mbrotjen e të drejtave të qytetarëve si dhe për një jetë më të sigurt.*

## **QËLLIMET E HULUMTIMIT**

Studimi do të synojë që të kontribuojë në kuptimin e përmasave dhe thellësisë së zbatimit të dënimit me burgim të përjetshëm në R.Maqedonisë nëpërmjet hedhjes dritë në frekuencën të zbatimit të këtij dënimi kategorizimin e veprave penale për të cilat u shqiptohet ky lloj dënimi në motivet dhe shkaqet të kryesve të veprave penale që u shqiptohet ky lloj dënimi, shkallën e tolerancës qytetare ndaj kryesve të veprave penale të cilave duhet të shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm dhe nga ana tjetër reagimin ligjor ndaj veprave të tilla që u shqiptohet ky lloj dënimi si dhe në vakumin ligjor për shqiptimin e këtij dënimi.

Për të arritur qëllimin e studimit parashoh të përdorë metodologji të pasur kërkimore duke nisur me rishikimin e literaturës relevante (studime të mëparshme, nga kuadri ligjor, nga hulumtime të ndryshme nga raporte të ndryshme nga analizë të ndryshme) për të ofruar konceptimin teorik të nocioneve kryesore të studimit. Poashtu gjatë këtij hulumtimi do të përdorë edhe të dhënat apo statistikat nga gjykatat në Maqedoni për zbatimin e këtij dënimi ku këto statistika apo të dhënat nga gjykatat do të ma lehtësonin tejë mase realizimin e studimit për ta kuptuar më mirë përmasat e këtij studimi.

Poashtu gjatë këtij hulumtimi do të përdorë edhe metodën e anketës për të mbledhur të dhëna nga qytetarët lidhur me zbatimin e dënimit me burgim të përjetshëm në R.Maqedonisë çka mendojnë qytetarët për këtë lloj dënimi, çka mendojnë për zbatimin e këtij lloj dënimi cilët lloj të veprave penale duhet të përfshihen sipas tyre a zbatohet në mënyrë të drejtë për të gjithë veprat penale në mënyrë të drejtë sipas tyre është e drejtë dhe human dhe i drejtë ky lloj dënimi çka mendojnë ato etj ku këto të dhëna do të përbejnë bazën kryesore të studimit.

## **HIPOTEZAT**

Hartimi i kornizës hipotetike që përfshin hipotezën e përgjithshme dhe ato të veçanta të studimit ndihmon shumë në përfitimin e një kuptimi të plotë dhe të qartë të studimit të propozuar, pyetjeve apo çështjeve kryesore kërkimore që do të hulumtohen. Hipoteza e përgjithshme e studimit të ZBATIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË R. Maqedonisë është përfshirë në vete kërkesën e bërë nga hulumtuesi ku kjo hipotezë përfshin rekomandimin e qartë të hulumtuesit për këmbnguljen dhe insistimin e institucioneve por edhe vetë qytetarëve për të parandaluar veprat e rënda penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm apo për të reduktuar që këto vepra e rënda penale që të mos të kryen ku për këto vepra është parapaër ky lloj dënimi ku këto vepra të rënda penale dëmtojnë të gjithë pra dëmtojnë të gjithë qytetarët në përgjithësi dhe pasojat nga kryerja e këtyre veprave penale të rënda për të cilat është paraparë ky lloj dënimi janë shumë të rënda dhe katastrofale.

Hipotezat e veçanta janë të lidhur ngushtë me fokusin e hulumtimit si dhe me hipotezën e përgjithshme.

Pra këto hipoteza të veçanta përfshin :

1. Paraqitjen e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.
2. Roli i gjykatave dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi në marjen e vendimeve për personat që kryejnë veprat e rënda penale për të cilat është parapara ky lloj dënimi.
3. Nivelin e respektimit të rregullave apo normave të së drejtës .
4. Kategorizimin e veprave të rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi duke pasur parasysh moshën, gjininë, motivet, shkaqet, të kryersve të veprave të tilla penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm.
5. Mbrotja efikase ligjore që ofrohen për të dëmtuarit nga veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.

## KAPITULLI I PARË

### 1. NOCIONI I SISTEMIT TË DËNIMEVE

Në shkencën e së drejtës penale njihet nocioni formal dhe material i dënimit. Nocioni formal përcaktohet duke pasur parasysh elementet juridike të dënimit, siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj, ligjshmëria me rastin e shqiptimit, organi i cili është kompetent për shqiptimin e tij, procedura gjyqësore që duhet të respektohet për të mundur të shqiptohet, etj. Nocioni material i dënimit përcaktohet duke pasur parasysh qëllimin e tij. Sipas këtij kuptimi, qëllimi kryesor i dënimit është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe preventiva me qëllim që kryesi në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe përmirësimi i tij, si dhe ruajtja e disiplinës së caktuar të qytetarëve në shoqëri. Penologjia, shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ose si quhet në disa vende e drejta mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, është një disiplinë e rëndësishme e cila ka lëndën dhe metodat e veta të pavarura të studimit.<sup>1</sup> Në shkencën e së drejtës penale njihet nocioni formal dhe material i dënimit. Nocioni formal përcaktohet duke pasur parasysh elementet juridike të dënimit, siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj, ligjshmëria me rastin e shqiptimit, organi i cili është kompetent për shqiptimin e tij, procedura gjyqësore që duhet të respektohet për të mundur të shqiptohet, etj. Nocioni material i dënimit përcaktohet duke pasur parasysh qëllimin e tij.<sup>2</sup> Sipas këtij kuptimi, qëllimi kryesor i dënimit është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe preventiva me qëllim që kryesi në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe përmirësimi i tij, si dhe ruajtja e disiplinës së caktuar të qytetarëve në shoqëri. E dr. jonë penale nuk njeh dënimin me vdekje. Ky lloj dënimi është abroguar më 1999, dhe në vend të dënimit me vdekje, është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, 21 – 40 vjet. Çdo dënim paraqet marrje apo kufizim të të mirave të kryesit të veprës penale. Në ato kushte ku parashihet dënim me vdekje – i merret jeta e njeriut, me dënim me burgim – liria e qarkullimit, ndërsa me dënim me gjobë – i merret pasuria.<sup>3</sup> Me dënime alternative kryesit i caktohen obligimet të posaçme dhe nëse ai nuk i përmbushë, detyrohet të mbajë dënimin me burgim, ndërsa me dënime plotësuese kryesit të veprës penale i merren apo i kufizohen disa liri dhe të drejta. Karakteristikë e përgjithshme e sistemit të dënimeve të parapara në kodin penal të Maqedonisë është se parasheh një numër relativisht të madh të llojeve të dënimeve. Që dallohen për

<sup>1</sup> Françoise Tulkens, *Negotiated Justice, European Criminal Procedures*, (ed. Dalmans-Marty/ Spencer),

<sup>2</sup> Vllado Kambovski, *E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme*, Shkup, 2016, fq.835

<sup>3</sup> Vllado Kambovski, *E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme*, Shkup, 2016, fq.835

nga koncepti dhe përmbajtja e tyre, sidomos kanë dallime konceptuale dhe përmbajtësore dënimet alternative, në krahasim me dënimet kryesore. Në radhë të parë dënimet ndahen në ato kryesore dhe plotësuese (sekondare).

1. **Dënimet kryesore(primare)** – janë ato të cilat ligji i parasheh se mund të shqiptohen si masë kryesore e ndëshkimit. Këto janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryesit të veprës penale, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimit. Sipas kodit penal dënimet kryesore janë: dënimi me burgim afatgjatë, dënim me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimi me gjobë mund të jetë kryesor (kur për veprën penale të caktuar është i paraparë si i vetmi dënim) dhe plotësues, sekondar (kur për një vepër është paraparë në mënyrë kumulative me dënimin me burgim. Si dhe kur është paraparë në mënyrë alternative së bashku me dënimin me burg mund të jetë kryesor dhe plotësues).<sup>4</sup>

2. **Dënimet plotësuese** – janë ato lloje të dënimeve të cilat mund të shqiptohen vetëm krahas dënimit kryesor apo alternativ. Dënimet plotësuese në fakt janë dënime komplementare dhe duhet ta forcojnë efektin e dënimit kryesor. Bashkë me dënimin kryesor ose alternativ, mund tu shqiptohen edhe këto dënime plotësuese: gjoba, heqja e së drejtës për tu zgjedhur, ndalimi i ushtrimit administrativ- publik, ndalimi i ushtrimit të profesionit, marrja e patentë shoferit, marrja e sendit, etj.

3. **Dënimet alternative** – janë rezultat i trendeve bashkëkohore në të dr. penale<sup>5</sup> dhe kanë për qëllim që në të gjitha rastet e mundshme të parapara me ligj, në vend të dënimit me burgim, të shqiptohen dënimet alternative, që janë dënime jo izoluese, dhe jo me burgim. Nëse për një vepër penale janë të parapara shumë dënime, vetëm njëri prej tyre mund të jetë kryesor. Dënimet ndahen edhe në permanente dhe kohore. Dënimet permanente – janë ato të cilat kryesit të veprës penale i shqiptohen për gjithë jetën, të cilat ndryshe quhen edhe dënime të përjetshme. Kodi ynë penal nuk parasheh këto dënime. Kurse dënimet kohore – janë ato që shqiptohen për një kohë të kufizuar. Dënimi kohor parasheh kufijtë e posaçëm për çdo vepër penale. Psh., minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është – 15 ditë, dhe maksimumin e përgjithshëm – 20 vjet. Kurse minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim afatgjatë është – 21 vjet dhe maksimumi i përgjithshëm është – 40 vjet.<sup>6</sup>Dënimet në mënyrë kumulative janë të përcaktuara atëherë kur gjykata është e obliguar që t’ia shqiptojë të gjitha ato dënime kryesit të veprës penale, psh., në mënyrë kumulative është

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Vllado Kambovski, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2016, fq.836

<sup>6</sup> Po aty.

paraparë dënimi për veprën penale të fshehjes së tatimit (dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë). Në mënyrë alternative dënimet janë të parapara kur gjykata mund të shqiptojë vetëm njërin prej tyre. Ndërsa dënimi me burgim afatgjatë në të drejtën tonë penale është paraparë gjithëherë në mënyrë alternative.

**Dënimi me burgim** – Është lloj i dytë i dënimit me heqje të lirisë i paraparë në kodin penal të Maqedonisë. Edhe ky dënim është dënim kryesor, mirëpo ndryshe nga dënimi me burgim afatgjatë, dënimi me burgim është i paraparë për numrin më të madh të veprave penale. Shqiptimi i dënimit me burgim është paraparë gjithëherë edhe në mënyrë alternative me dënimin me burgim afatgjatë. Në disa raste në raport me dënimin me gjobë është paraparë në mënyrë alternative apo kumulative. Ndërsa, në raport me dënimet plotësuese, dënimi me burgim gjithëherë është paraparë në mënyrë kumulative. Në kodin penal është përcaktuar minimumi i përgjithshëm – 15 ditë dhe maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim – 20 vjet. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, por nëse gjykata e shqipton në kohëzgjatje prej 6 muajsh, atëherë mund të shqiptojë edhe në ditë të plota.<sup>7</sup>

## 1.2 Evolucion i dënimit

Me matjen e dënimit kuptojmë caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për kryerësin e veprës penale, në mënyrë që ti caktohet ai lloj dhe masë e dënimit i cili do ti përgjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryesit dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi i dënimit. *Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë* për çdo vepër penale të veçantë parashikon lartësinë e dënimit, pra kufirin më të lartë dhe më të ulët të llojit të dënimit që mund të jepet ndaj kryerësit të veprës penale. Për përcaktimin e lartësisë së dënimit ligjvënësi nisët nga rrezikshmëria shoqërore që paraqet vepra penale konkrete, për të parandaluar kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale. Kodi penal për vepra penale të njëjta parashikon edhe dënime alternative, midis të cilave gjykata ka mundësi të zgjedhjes për ti zbatuar ndaj një personi të caktuar, por për të cilat paraprakisht duhet të plotësohen kushtet ligjore të parashikuara me ligj. Gjithashtu kodi i njeh të drejtën gjykatës që ndaj kryerësve të veprave penale të caktoj edhe dënimet plotësuese. Për caktimin e dënimit karakteristike janë dobishmëria shoqërore e dënimit dhe individualizim<sup>8</sup> i tij.

<sup>7</sup> Vllado Kambovski, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2016, fq.835

<sup>8</sup> Kodi penal i Kosovës neni 64

Dobishmëria shoqërore e dënimit ka të bëjë me efektin e dënimit në rastin konkret, nëse lloji i dënimit të dhënë është më i përshtatshmi për rastin konkret. Dobishmëria kërkon individualizim të drejtë të dënimit që gjykata do të caktojë për të pandehurin, me anën e të cilit<sup>9</sup> arrihen qëllimet e dënimit. Dënimi i përshtatshëm jo vetëm që parandalon veprimtarinë e mëtejshme kriminale të kryerësit të veprës penale, por i shtrin efektet edhe më gjerë në pjesët e tjera të shoqërisë, çka do të thotë se i përmban personat tjerë nga kryerja e veprave penale.<sup>10</sup> Në burg të përjetshëm mund të përfundojnë edhe kidnapuesit. Dënimi i përjetshëm është paraparë edhe për dhunuesit. Po ashtu edhe hakmarrja që përfundon me vrasje kualifikohet si vepër e dënueshme me burgim nga 15 vjet deri në burgim të përjetshëm. Burgimi i përjetshëm, sipas tij, nuk mund t'u shqiptohet personave të cilët janë nën moshën 21-vjeçare dhe atyre me sëmundje mendore, edhe nëse i kryen këto vepra jashtëzakonisht të rënda, që parashihen me Kodin Penal. Në punim jemi munduar që të trajtojmë në mënyrë të hollësishme mënyrën - metodologjinë e matjes së dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal si dhe zbatimin e tyre si dhe qëllimin e dënimit. Jemi ndalur në to, duke pasur parasysh faktin se është detyrim ligjor i gjykatës të marrë në konsideratë këto rrethana, të cilat e ndihmojnë atë në vlerësimin sa më objektiv të rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit dhe të veprës penale. Vetëm duke bërë këtë vlerësim gjykata do të mund të ndihmohet në caktimin e një dënimi të drejtë, i cili do të ketë efektin e duhur edukativ e parandalues. E dr. jonë penale nuk njeh dënimin me vdekje. Ky lloj dënimi është abroguar më 1999, dhe në vend të dënimit me vdekje, është paraparë dënimi me burgim afatgjatë, 21 – 40 vjet.<sup>11</sup>

Çdo dënim paraqet marrje apo kufizim të të mirave të kryerësit të veprës penale. Në ato kushte ku parashihet dënimi me vdekje – i merret jeta e njeriut, me dënim me burgim – liria e qarkullimit, ndërsa me dënim me gjobë – i merret pasuria. Me dënime alternative kryesit i caktohen obligimet të posaçme dhe nëse ai nuk i përmbushë, detyrohet të mbajë dënimin me burgim, ndërsa me dënime plotësuese kryesit të veprës penale i merren apo i kufizohen disa liri dhe të drejta. Karakteristikë e përgjithshme e sistemit të dënimeve të parapara në kodin penal të Kosovës është se parasheh një numër relativisht të madh të llojeve të dënimeve që dallohen për nga koncepti dhe përmbajtja e tyre, sidomos kanë dallime konceptuale dhe përmbajtësore dënimet alternative, në krahasim me dënimet kryesore. Në radhë të parë dënimet ndahen në ato kryesore dhe plotësuese (sekondare). 1. Dënimet kryesore (primare) – janë ato të cilat ligji i

<sup>9</sup> Dr. Ismet Salihu “ E Drejta Penale” Pjesa e përgjithshme Prishtinë 1995 fq 502

<sup>10</sup> Dr. Ismet Salihu “ E Drejta Penale” Pjesa e përgjithshme Prishtinë 1995 fq 502

<sup>11</sup> Po aty.

parasheh se mund të shqiptohen si masë kryesore e ndëshkimit. Këto janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryesit të veprës penale, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimit. Dënimet në mënyrë kumulative janë të përcaktuara atëherë kur gjykata është e obliguar që t'ia shqiptojë të gjitha ato dënime kryerësit të veprës penale, psh., në mënyrë kumulative është paraparë dënimi për veprën penale të fshehjes së tatimit (dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë). Në mënyrë alternative dënimet janë të parapara kur gjykata mund të shqiptojë vetëm njërin prej tyre. Ndërsa dënimi me burgim afatgjatë në të drejtën tonë penale është paraparë gjithëherë në mënyrë alternative.<sup>12</sup>

“Varja nuk është një makinë e vdekjes, por është një simbol i terrorit, mizorisë dhe shpërfilljes ndaj jetës; emërtues i përbashkët i kësaj egërsie primitive, fanatizmi mesjetar dhe totalitarizmi modern. Ajo qëndron për gjithçka që njerëzimi duhet ta refuzojë, nëse aspiron mbijetimin e krizës së tanishme”.<sup>13</sup> Në këto momente, vetëm në SHBA, 3261<sup>14</sup> njerëz po presin që të ekzekutohen si pasojë e dënimit me vdekje të shqiptuar ndaj tyre. Ky studim ka për qëllim analizimin e opinionit publik lidhur me dënimin me vdekje, duke ofruar argumente pro dhe kontra çështjes në fjalë.

Së pari, ofron një pasqyrë të dënimit, si mjet i paraparë ligjor për të ndëshkuar të gjithë ata që nuk respektojnë rendin e ligjin; dhe së dyti, fokusohet në praktikën gjyqësore. Përveç pikave të lartë-përmendura, ky studim ndanë të dhëna të ndryshme, duke zbuluar kështu qëndrimet mbizotëruese në botë për dënimin me vdekje, si dënim kapital. “Më mungojnë yjet. E dini, nuk i kam parë për vite, e vite, e vite. Më mungon shiu. Më mungon ushqimi. Më mungojnë të gjitha këto. Por më e rëndësishmja – dhe ajo e cila do të më lëndojë më së shumti dhe të cilën do ta mbaj si mbresë më së gjati – është të trajtohem si qenie njerëzore.”<sup>15</sup> Pro: Filozofë të ndryshëm kanë qenë të mendimit se dënimi mund të arsyetohet në tri mënyra të ndryshme: ndëshkimi – që dënimi është hakmarrja e merituar ndaj kryesit të krimit për dëmin që ai ose ajo e ka shkaktuar; drejtësia – që ndëshkimi paraqet një mënyrë për të respektuar të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, duke imponuar kështu një barrë mbi atë person i cili ka për qëllim shmangiet e bindjes ndaj ligjit; dhe frikësimi – se dënimi është një e keqe e domosdoshme për të parandaluar të këqija të

<sup>12</sup> Dr. Ismet Salihu “E Drejta Penale” Pjesa e përgjithshme Prishtinë 1995 fq 366

<sup>13</sup> Peter HODGINSON dhe Andreë RUTHERFORD, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, Reflects on hanging, Neë York, Macmillan, 1957, f. 170.

<sup>14</sup> Statistika të dënimit me vdekje <http://www.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 09 gusht 2013.

<sup>15</sup> Intervistë në CNN me Damian Echeles, i cili është duke pritur ekzekutimin, pasi që u dënua me vdekje që nga viti 1993, <http://edition.cnn.com/2011/CRIME/01/13/mattngly.west.memphis.three/index.html>, qasur më 03.01.2019

tjera në të ardhmen duke i dekurajuar kështu kriminelët potencial.<sup>16</sup> Mirëpo, pavarësisht mbështetjes së dënimit me vdekje, filozofi Immanuel Kant, dallon një të metë të këtij sistemi duke u shprehur se për të dënuar dikë sa për të frikësuar të tjerët, nënkupton se ky person përdoret vetëm si mjet dhe në këtë mënyrë ndaj tij bëhet padrejtësi.<sup>17</sup> Pra, nëse ne dënojmë vetëm për t'i dhënë kryerësit të krimit një ndëshkim dhe kjo nuk mjafton për të frikësuar kryerësit e ardhshëm të krimeve, do të thotë se ne po krijojmë padrejtësi për viktimat potenciale. Kontra: Si argumente kontra hasim në dy vlera thelbësore të cilat janë të garantuara me Konventa Ndërkombëtare e Regjionale për të Drejtat e Njeriut<sup>18</sup> : e drejta për jetë dhe vlera e saj. Qëllimi i dënimit mbi të gjitha është pengesa, e jo vdekja.<sup>19</sup> Shpenzimet marramendëse për ekzekutimin e dënimit me vdekje gjithashtu njihen si arsye themelore, e të cilat mbështesin argumentin kontra. Si shembull të përshtatshëm mund të përmendim rastin e ekzekutimit të Timothy McVeigh<sup>20</sup> në SHBA, për bombardimet në Oklahoma City të cilat kaluan shifrën 13 milion dollarë. Si rrjedhojë, në New-York dhe New Jersey, për po këtë arsye të lartpërmendur, dënimi me vdekje u hoq. Kjo si rezultat i shpenzimeve marramendëse prej 170 milion dollarëve në New-York për periudhën prej 9 vitesh<sup>21</sup> dhe New Jersey prej 253 milion dollarë për periudhën prej 25 vjetëve<sup>22</sup> 0, duke mos ekzekutuar asnjë të dënuar me vdekje. Ndërkaq, sipas të dhënave të nxjerra nga Gallup, thuhet se shpenzimet mesatare për një proces gjyqësor, e që krimi i kryer dënohet me vdekje, kushton rreth 2.4 milion dollarë.<sup>23</sup>

Sipas Amnesty International, kundër dënimit me vdekje renditen një numër i madh i shteteve ku deri në maj të vitit 2012, 140 shtete<sup>24</sup> e kanë shfuqizuar atë në ligj ose praktikë. Por mbetet ende një

<sup>16</sup> Immanuel KANT, *The Metaphysics of Morals*, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar original më 1779, f.69.

<sup>17</sup> Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Protokollin nr.13, Neni 1, shih dhe 6 Moratoriumi lidhur me aplikimin e dënimit me vdekje, Rezoluta A/C.3/62/L.29 e OKB-së e datës 15 nëntor 2007, <http://ëëë.un.org/apps/neës/story.asp?NeësID=24679#.Ugarr9Iëqk0>, qasur më 09 gusht 2013

<sup>18</sup> Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, *The death Penalty For and against*, publikuar nga Roëman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998, f. 33.

<sup>19</sup> Shpenzimet e ekzekutimit të Timothy McVeigh, <http://www.guardian.co.uk/ëorld/2001/jun/30/mcveigh.usa> 09 gusht 2013.

<sup>20</sup> Costs on Death Penalty, Death Penalty Information Center, New York <http://www.deathpenaltyinfo.org/costs-death-penalty#FromDPIC>, 09 gusht 2013.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Statistika të dënimit me vdekje <http://ëëë.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 9 gusht 2013

<sup>23</sup> Abolitionist and retentionist countries, Amnesty International, <http://ëëë.amnesty.org/en/deathpenalty/abolitionist-and-retentionist-countries>, 09 gusht 2013.

<sup>24</sup> Raporti për vitin 2012 i Amnesty Internacional, f. 34-35, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/ACT50/001/2013/en/bbfea0d6-39b2-4e5f-a1ad885a8eb5c607/act500012013en.pdf>, 09 gusht 2013.



numër i madh shtetesh të cilat vazhdojnë të shqiptojnë të tilla dënime. Vendet me numrin më të madh të ekzekutimeve janë: Kina, Irani, Arabia Saudite, Iraku dhe SHBA-të<sup>13</sup>, ndërkaq në Evropë hasim vetëm Bjellorusinë<sup>25</sup> Dënimi me vdekje është dënimi më i rëndë që mund t'i shqiptohet një njeriu. Ai mundësohet nga ligjet të cilat, edhe pse paradoksalisht e ndalojnë vrasjen, në të njëjtën kohë janë makinë e kryerjeve të kësaj vepre e cila bije në kundërshtim të plotë me lirinë dhe të drejtën e jetës që njëkohësisht ofrohet nga ligji. Në teorinë e së drejtës penale qysh herët është parashtruar çështja e bazës juridike të dënimit. Çështja ka të bëjë me dhënien e përgjegjes : se në bazë të çfarit, shoqëria- shteti ka të drejtë në dënimin e kryerësit të veprës penale , nga rrjedh e drejta e shtetit në dënim—ius puniendi. Domethënia praktike e kësaj çështje ka të bëjë me përcaktimin e kufijve të represionit juridiko-penal, gjegjësisht kufijtë e të drejtës së shtetit në ekzekutimin e dënimit .

### 1.3 Teoritë për qëllimin e dënimit

Që nga kohërat më të lashta shoqëritë njerëzore dhe grupet e ndryshme kanë bërë përpjekje për pengimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të rrezikshme në shoqëri dhe që atëherë ka pasur reagime ndaj veprimeve dhe sjelljeve të ndryshme të cilat kanë cënuar interesat, vlerat dhe normat më vitale të individëve, grupeve dhe bashkësive të caktuara.<sup>26</sup> Dënimi është lloji më i vjetër i sanksionit penal, ka lindur nga gjakmarrja dhe kompozicioni, si forma të para të reagimit të shoqërisë ndaj veprave të ndaluara të individëve. Gjerë në fund të shekullit XIX dënimi ka qenë i vetmi lloj i sanksionit penal, edhe sot dënimi është sanksion themelor, shqiptohet më së shpeshti ndaj kryerësve të veprave penale.<sup>27</sup> E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji<sup>28</sup> Çdo kush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.<sup>29</sup> Për t'u shqiptuar një dënim duhet të ekzistojë vepra penale, elementet e saj, siç janë: sjellja e njeriut (veprimi ose mosveprimi), rrezikshmëria shoqërore, përcaktimi i një vepre

---

<sup>25</sup> Po aty, f. 68,

<sup>26</sup> Halili, dr. Ragip penologjija shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, 2005, Prishtine, faqe 29,

<sup>27</sup> Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 431

<sup>28</sup> Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut, neni 2

<sup>29</sup> Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut, neni 5,

penale, pasoja, lidhja shkakësore mes veprimit (mos veprimit) dhe pasojës, përgjegjësia penale. Qëllimet e dënimit janë: 1. Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, 2. Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale.<sup>30</sup> Filozofi i lashtë grek Platoni, qëllimin e dënimit e ka përcaktuar në këtë mënyrë “Kush ndëshkohet në mënyrë të drejtë duhet të bëhet i mirë dhe të përfitojë nga dënimi, ose ai duhet të bëhet shembull për të tjerët. Kështu ata do të shikojnë çfarë ai vuan dhe do të frikësohen të vuajnë edhe ata” Pra qëllimi që një person të privohet nga liria është që ai të riedukohet, risocializohet, të bëhet i dobishëm për rrethin familjar, dhe kur të lirohet të jetë më i përgjegjshëm për veprimet e tij në të ardhmen. Gjatë përgjegjes në këtë pyetje filozofiko, politiko e juridike, janë zhvilluar shumë teori nga të cilat më të njohurat janë:

- 1) Teoria idealiste,
- 2) Teoria e kontrates shoqërore,
- 3) Teorija Juridike,
- 4) Teoritë Sociologjike.

Sipas teorive Idealiste – baza e së drejtës së shtetit në dënim është kërkesa e së drejtës absolute. E drejta absolute është kategori ideore nga e cila rrjedhë e drejta e shtetit në përgjithësi, kështu, që edhe e drejta në zbatimin e dënimit. Me kryerjen e veprës penale vjen deri te rrënimi (shkelja) e të drejtës absolute e cila mundet sërish të rivendoset vetëm me zbatimin e dënimit ndaj kryerësit të veprës penale. Drejtësia absolute mundë të kuptohet në mënyra të ndryshme, kështu, që në kuadër të këtyre teorive dallohen 3 qasje e ato janë:

- a) Teoria e të drejtës së perëndisë,<sup>31</sup>
- b) Teoria e të drejtës morale,
- c) Teoria e të drejtës zakonore .

Sipas teorisë së të drejtës së perëndisë e drejta e dënimit është e prejardhjes hyjnore, por me krijimin e shtetit kjo e drejtë – e drejta në dënim ndaj kryesit është bartë nga perëndia në shtetë. Prandaj në bazë të asaj që u tha del se shteti është vetëm një zbatues i thjeshtë i një të 112 drejta të Perëndisë, e cila e drejtë është e karakterit imperativ ngase mbështetet në kërkesën që të dënohet secili që shkel rregullat, përmes kryerjes së ndonjë vepre penale Teoria e të drejtës morale—

---

<sup>30</sup> Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 433-434-435

<sup>31</sup> <https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true>

konsideron se baza e së drejtës së shtetit në aplikimin e dënimit rrjedh nga normat morale të cilat zotrojnë botën dhe të cilat gjinden në vetëdijen e se cilit individ.<sup>32</sup>

Sipas I. Kant normat morale janë të përmbledhura në vetëdijen e secilit individ që disponon mendje të shëndoshë, kështu,që qdo njeri i arsyeshëm është në gjendje ti vlersoj veprimet e veta dhe të kuptoi se cka është e lejuar e cka jo. Kundër atij i cili sillet në mënyrë të pa,lejuar në vetëdijen e se cilit paraqitet kërkesa për zbatimin e dënimit cili ka karakter të imperativit kategorik. Teoria e së drejtës ligjore-(Hegeli) - konsideron se baza e së drejtës në dënim është në domosdoshmërinë dialektike. Në shtetin si formën më të lartë të idesë absolute ekziston një e drejtë ligjore e përcaktuar.Me kryerjen e veprës penale kjo e drejtë refuzohet (atakohet) kështu,që ndaj personit si kryerës të saj duhet të zbatohet dënimi si kundërmasë për veprën e kryer përmes të cilit (dënimit) rivendoset e drejta.<sup>33</sup>

Pra vepra penale është negacion i së drejtës, kurse dënimi është negacion i negacionit , përmes të cilit sërish rivendoset rendi i rënuar juridik. Teoria e kontrates shoqërore (Rruso, Grocius, Lok, Hobs) ---konsideron se individët si pjestar të shoqërisë në shkallën e caktuar të zhvillimit të sajë e kanë, kuptuar se më nuk janë në gjendje që individualisht të kujdesen për mbrojtjen e të mirave dhe interesave të tyre . Para vrullit të kriminalitetit kanë vendosur të formojnë shtetin dhe në të të bartin të drejtat e tyre në mbrojtjen nga sjelljet e pa lejuara dhe të kundërligjshme. Duke hequr dorë ashtu në dobi të shtetit për dënimin, individët gjithashtu kanë pranuar që edhe vetë të jenë të dënuar nëse e shkelin ligjin dhe kryejn vepra penale. Kështu,që në bazë të kësaj që u tha del se baza juridike e dënimit gjindet në kontratën shoqërore të individit nga e,cila u themelua shteti .<sup>34</sup>

Teoritë juridike — mbi bazën juridike të dënimit, zgjidhjen në këtë çështje e shohin në normat e së drejtës pozitive .Shteti ka kompetenca të nxjerr norma përmes të cilave rregullohet jeta e njerëzve, kështu,që nga kjo rezulton edhe kompetenca e shtetit që të siguroj zbatimin e ligjit . Kjo do të thotë se shteti ka të drejtë të nxjerr norma përmes të cilave rregullohet sjellja e individëve , kërkohet nga qytetarët dëgjueshmëri si dhe ndëshkim për të pa dëgjueshmit si dhe për ata të cilët nuk e respektojnë normën . Njëri ndër përfaqësuesit e këtyre teorive është autori Binding i cili konsideron se shteti ka të drejtë në vetëmbrojtje nga kryerësit e veprave penale të cilët kanë shkelur ndonjë normë juridike dhe të cilët kan rrezikuar të mirat juridike të mbrojtura .Teoritë sociologjike – bazën juridike të dënimit e shohin në funksionin social të së drejtës penale . Sipas teorisë utilitare (Bentam)

<sup>32</sup> <https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true>

<sup>33</sup> Po aty,

<sup>34</sup> Bajallxhiev.D, Hyrje në drejtësi, Shkup 2007

dënimi ka arsyeshmërinë dhe dobinë e zbatimit të vet. Sipas Listit – baza juridike e dënimit rezulton nga nevoja e ruajtjes së rendit juridik dhe sigurisë së shtetit . Nevoja e shtetit për zbatimin e dënimit rezulton nga nevoja e ruajtjes dhe e sigurimit të mirave dhe vlerave më të rëndësishme shoqërore nga të gjitha format e shkeljes dhe rrezikimit të tyre.<sup>35</sup>

### 1.3.1 Teoritë absolute për dënimin adekuat

Se çka arrihet me zbatimin e dënimit janë shfaqur mendime dhe teori të ndryshme filozofike dhe juridike, e të cilat mund të radhiten në tri grupe themelore:

1. Teoritë absolute
2. Teoritë relative dhe
3. Teoritë e përziera apo eklektike.

**Sipas teorisë absolute – qëllimi i dënimit**<sup>36</sup> është hakmarrja ndaj personit që kryen veprë penale si e metë kryesore e kësaj teorie është se këto në tërësi injorojnë qëllimin social të dënimit.

Teoritë e përziera më së miri e përcaktojnë qëllimin që duhet të arrijë dënimi. Sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, qëllimi i dënimit nuk mund të arrihet vetëm me represion (hakmarrje) por jo edhe vetëm me preventivë. Kryerësi i veprës penale duhet të dënohet për shkak se ka kryer veprë të dëmshme, por ai duhet të dënohet edhe me qëllim mos të kryej më veprë të kundërligjshme, pra të përmirësohet. Në teorinë e së drejtës penale që moti është parashtruar pyetja se cka paraqet qëllimi i dënimit , që do të thotë se cka dëshirohet dhe cka mund të arrihet me rastin e zbatimit të dënimit ndaj kryerësve të veprave penale .Sipas teorive absolute qëllimi i dënimit është hakmarrja, represioni ndaj kryerësit për veprën e kryer. Të keqen e shkaktuar ndaj kryerësit me rastin e shqiptimit të dënimit, kryerësi i veprës duhet ta përjetojë gjatë vuajtjes. Andaj qëllimi i dënimit është hakmarrja, shpagimi nga pikpamja e shoqërisë, gjegjësisht vuajtja nga pikpamja e kryerësit të veprës. Teoritë relative hudhin poshtë qasjen sipas së cilës hakmarrja është i vetmi qëllim i dënimit, dhe konsiderojnë se dënimi paraqet mjetin e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i dënimit është në dobishmërinë shoqërore cka do të thotë se sa mundë të ndihmojë ai si mjet efikas në luftimin e kriminalitetit (funksioni utilitar). Qëllimi themelor i dënimit është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen.

---

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> Po aty.

Nuk dënohet kryerësi për atë që ka gabuar por se që të mos gabojë më. Në varshmëri nga kjo se si realizohet ky qëllim dallohen:

- 1) Teoria e prevencionit individual, dhe special
- 2) Teoria e prevencionit të përgjithshëm apo gjeneral.<sup>37</sup>

Sipas teorisë së frikësimit dënimi duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të kryerësi i veprës të shkaktoj frikë ashtu, që të pengohet në të ardhmen në kryerjen e veprave penale. Teoria e përmisimit nisët nga supozimet se kryerësi i veprave është personaliteti të cilin mbisundojnë tipare negative, kështu që me anë të dënimit të ndikohet që ato karakteristika negative të shuhen dhe të zhvillohen karakteristika pozitive.

Në mënyrë që kjo të arrihet dënimi duhet të jetë mjet për përmisim mjet i cili mund të ndërrohet, përshtatet karakteristikave psikologjike të kryerësit të veprave penale. Sipas teorisë së kujdestarisë - kryerësi i veprës është personaliteti jo-rezistent në ndikimet nga jashtë kështu, që rezultojnë të jetë i përshtatshëm për kryerjen e veprave penale. Me rastin e dënimit të tij ai vihet nën perkujdesje të organeve shtetërore, organeve të gjyqësisë, të sigurisë publike të cilat kanë për detyrë që të aftësojnë për të udhëhequr konform rregullave të shoqërisë dhe të respekton normat e rendit juridik dhe të disiplinës shoqërore. Teoritë e prevencionit gjeneral konsiderojnë se qëllimi i dënimit është ndikimi në masën të gjërë të qytetarëve në mënyrë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale. Me të vepruarit e tillë të dënimit paraprakisht parandalohen qytetarët të cilët janë të prirur për kryerjen e veprave penale që të mos i kryejnë ato dhe ashtu të shmangen zbatimin të dënimit<sup>38</sup>

Sipas teorisë së frikësimit të përgjithshëm me dënimin e paraparë (teoria e detyrimit psikologjik) i bëhet me dije secilit qytetar se e keqja do të ndodhë nëqoftëse ata kryejnë vepra penale. Kërcënimi me dënim ndikon si detyrim psikologjik në të gjithë delikuentët potencial që të përmbahen nga shkelja e rregullave dhe të mos kryejnë vepra penale. Sipas teorisë së vërejtjes mbi dënimin e paraparë (teoria e detyrimit moral) u bëhet me dije qytetarëve se kryerja e veprave penale është amorale dhe e ndaluar, dhe natyrisht e dënueshme. Dënimi asisoj lufton karakteristikat amorale të cilat ekzistojnë te disa qytetarë dhe në anën tjetër ngritë moralin e përgjithshëm të shoqërisë. Teoria e frikësimit me ekzekutimin e dënimit konsideron se parandalimi i kriminalitetit më së miri arrihet

<sup>37</sup> Bajallxhiev.D, Hyrje në drejtësi, Shkup 2007

<sup>38</sup> Mishelin.R.Ishej, Të drejtat njerëzore, përmbledhjeve themelore e eseve politike, fjalimeve dhe dokumenteve, Shkup, 2002

me ekzekutimin e dënimit ndaj të gjykuarëve.<sup>39</sup>Ky ekzekutim duhet të jetë ashtu që të shkaktoj frikë në masë. Në mënyrë që kjo të arrihet dënimet duhet të ekzekutohen hapur dhe të jenë të ashpra apo në mënyrë të tillë që për to të flitet në masë nga njëri në tjetrin. Teoritë e përziera (eklektike ) këto teori kan lindur si bashkim i elementeve të atyre absolute dhe atyre relative.Sipas kësaj qasje qellimi i dënimit nuk mund të realizohet vetëm me hakmarrje e as vetëm me parandalim. Dënimi duhet të ketë qëllim parandalimin do të thotë parandalimin e kryerjes së veprave në të ardhmen. Me gjith atë dënimi zbatohet me rastin e kryerjes së ndonjë vepre penale dhe natyrisht ndaj kryerësit të asaj vepre dhe ngushtë paraqet detyrimin dhe masën retributive (masën e kufizimit apo marrjen e të mirave juridike lirin dhe të drejtën) dënohet për atë që ka gabuar, mirëpo edhe për atë që të mos gaboj më.

### **1.3.2 Teoria relative për dënimin**

**Teoritë relative** hedhin poshtë qasjen, sipas së cilës hakmarrja është i vetmi qëllim i dënimit dhe konsiderojnë se dënimi paraqet mjetin e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i dënimit gjendet në dobishmërinë shoqërore, që do të thotë në faktin se sa mund të shërbejë dënimi si mjet efikas në luftën kundër kriminalitetit (edhe ky një funksion utilitar). Në këtë kuptim, qëllimi themelor i dënimit është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen. Autori nuk dënohet për atë që ka bërë, por që të mos gabojë më në të ardhmen. Sipas teorisë relative – dënimi nuk duhet të jetë qëllim në vete por mjet për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, platformë kryesore është preventiva e kriminalitetit.<sup>40</sup>

### **1.3.3 Teoria integrative për dënimin**

**Teoritë e krimit dhe dënimit** janë bërë gjithnjë e më të larmishme pasi fenomeni i diversitetit është studiuar nga shkencat mjekësore, psikologjike, të sjelljes, sociale, ekonomike dhe politike. Një pasojë ka qenë braktisja e debateve bipolare, p.sh. për sa i përket meritës së Shkollës Klasike si kundër Shkollës Pozitiste ose vullnetit të lirë kundrejtë përcaktorizmit, apo deviancionit kundrejtë konformitetit. Propozimi që një fenomen i ndërlikuar shoqëror siç është krimi dhe dënimi i tij mund

---

<sup>39</sup> Mishelin.R.Ishej, Të drejtat njerëzore, përmbledhjeve themelore e esve politike, fjalimeve dhe dokumenteve, Shkup, 2002

<sup>40</sup> Vlado Kambovski, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2016, fq.873

të hulumtohet duke përdorur një parim të vetëm filozofik është më pak i pranueshëm në një botë postmoderne duke pasur parasysh që analizat e kufizuara në metamodologjinë apo metodologjitë e tyre ka të ngjarë të injorojnë më shumë faktorë sesa konsiderojnë. Për rrjedhojë, më shumë kriminologë dhe teoricienë po shqyrtojnë miratimin e kornizave integruese dhe / ose ndërdisiplinore për kërkime të reja, duke hapur derën për shumësinë krijuese të kornizave të bazuara në dije, përmes të cilave të shpjegojnë motivimin njerëzor, organizimin shoqëror dhe marrëdhëniet strukturore.

Sipas Barak (1998), integrimi përfshin lidhjen dhe / ose sintetizimin e modeleve dhe teorive të ndryshme në formulime të krimit dhe kontrollit të krimit që janë më gjithëpërfshirës, por progresi është i ngadaltë pasi ata që kanë fuqi mbi diskutet e veçanta të disiplinës i rezistojnë thithjes imperialiste në një ligjërim më i përhapur. Barak (1998):1) mbrojti një sintezë përmes narracionit: "konflikti që ekziston në kulturën tonë midis fjalorit të ligjërimit shkencor dhe të ligjërimit narrativ, midis pozitivizmit dhe romantizmit, objektivizmit dhe subjektivizmit, dhe midis sistemit dhe jetës mund të sintetizohet përmes një poetika e së vërtetës që i shikon shkencat shoqërore dhe shoqërinë si tekste".

Sipas kësaj pikëpamjeje, gjuha nuk është as pasqyrim i botës dhe i mendjes. Përkundrazi, është një praktikë historike shoqërore ku kuptimi i fjalëve nuk merret nga gjërat ose qëllimet, por lind nga veprimet e koordinuara shoqërore të njerëzve. Por propozime të tilla metodologjike janë përmbushur me pak aprovim. Për shembull, mbështetja e Realizmit Neo-Klasik dhe e Drejtë në kontrollin shoqëror dhe teoria e të mësuarit shoqëror i reziston referencës për çështje të historisë, gjinisë, ekonomisë dhe ligjit të interesit për kriminologjinë Marksiste, shkollën Feministe, etj.

Teoritë moderniste integruese ndryshojnë në shtrirjen e tyre. Disa përqëndrohen në lloje të veçanta të sjelljes ose shkelësve në modelimin e procesit shoqëror-mikro, p.sh. Eilson dhe Herrnstein (1985) u përqëndruan në sjelljen grabitqare të rrugës duke përdorur një model të zgjedhjes së sjelljes sociale të të mësuarit që mbështetet në përcaktimin e pozitivizmit dhe vullnetin e lirë klasik pasi konsideron lidhje të mundshme midis kriminalitetit dhe trashëgimisë, impulsivitetit, inteligjencës së ulët, praktikave familjare, përvojave shkollore, etj. dhe efektet e mediave masive tek individit.

Integrues të tjerë zhvillojnë modele të strukturës sociale-makro, p.sh. Quinney (1977) artikuloi një ekonomi politike dhe kulturë të krimit dhe kontrollit të krimit të bazuar në klasë-strukturë strukturore ku sundimi dhe shtypja përmes kriminalizimi drejtohej nga kapitalistët dhe agjentët e tyre të kontrollit. Title(1995) propozoi një teori të bilancit të kontrollit që pretendon se "sasia e kontrollit ndaj të cilit njerëzit i nënshtrohen sasisë së kontrollit që ata mund të ushtrojnë ndikon në

probabilitetin e tyre të përgjithshëm për të kryer disa akte devijante, si dhe mundësinë e kryerjes së tyre lloje specifike të devijimit ". Ai gjithashtu argumenton se raportet e kontrollit të individëve ose se procesi i balancimit të kontrollit i nënshtrohet një mori kontigjentesh të brendshme dhe të jashtme që mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.

Këto dhe teori të tjera të reja kujdesen më pak për vetë teorinë se,sa për njohuritë që ata përfaqësojnë, duke u përqëndruar në kauzën interaktive, reciproke, dialektike ose kodifikuese, duke sfiduar nëse ekziston një rënditje e saktë e variablave kauzal apo nëse marrëdhëniet janë konstante me kalimin e kohës. (shiko gjithashtu Messerschmidt (1997) i cili shqyrton faktorët e klasës, racës, gjinisë, etj.Në procesin e ndërtimit shoqëror që ndërmjetëson krimin në kontekste të veçanta shoqërore dhe ndryshime

#### 1.4 Qëllimi i dënimit në KPM-së

*Qëllim i përgjithshëm i sanksioneve penalo-juridike është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vlerat tjera themelore nga veprat penale.<sup>41</sup> Si qëllime të posaçme të **dënimit** përveç realizimit të drejtësisë, është: **a**-pengimi i kryerësit të kryejë vepra penale dhe **b**-riedukimi i tij si dhe ndikimi edukativ mbi të tjerët për të mos kryer vepra penale. Me këtë, ligji i thekson, në fakt funksionet polivalente të dënimit: retributivitetin dhe preventivën, preventivën gjenerale dhe speciale.*

Para ndryshimeve në KPM të vitit 2004, legjislacioni ynë penal njihnte vetëm **dy lloje** dënimesh; dënimin me burgim dhe dënimin me të holla (gjobë). Me këto ndryshime, raporti i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloj dënimesh që më parë ishin të parapara si masa të sigurisë.<sup>42</sup> Sipas KPM-së për vepra penale, kryerësve përgjegjës të veprave mund t'u shqiptohen **pesë lloje dënimesh**: dënim me burgim; dënim me të holla (gjobë); ndalimi i ushtrimit të profesionit; ndalimi i drejtimit të automjeteve dhe dëbimi i të huajit nga vendi.

Sipas KPM-së del se e drejta jonë e përvetëson preventivën e posaçme (speciale) dhe të përgjithshme (gjeneral) si qëllim të dënimit, në nenin 34 të Kodit Penal është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i dënimit. Si në legjislacionin penal të çdo shteti, ashtu edhe te ne, lloji dhe lartësia e dënimit përcaktohet sipas intensitetit dhe sasisë së të keqes që kryerësi i veprës penale ia ka shkaktuar individit dhe shoqërisë.

<sup>41</sup> Vllado.K&Ismail.Z, E drejta penale e përgjithshme, Tetove, 2018,fq.274

<sup>42</sup> Po aty



Kur gjykata shqipton dënim me burgim deri në një vit mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit me gjysmë liri, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësit esenciale familjare, apo nevojën për trajtim apo rehabilitim mjekësorë. Qëllimi i përgjithshëm i sanksioneve penalo-juridike- mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vlera themelore nga veprat penale (neni.2), KPM e karakterizon duke përcaktuar edhe qëllime të veçanta të sanksioneve të ndara ( neni.32 – dënimit; neni.48 – masat alternative; neni.60- masa të sigurimit; dhe neni.73- masa të sigurimit). Me theksimin e qëllimeve të posaçme potencohet edhe natyra e veçantë e llojeve të ndryshme të sanksioneve nga sanksionet me karakter retributive dënim deri te sanksionete preventive me karakter edukativ.<sup>43</sup>Si qëllime të posaçme të dënimit përveç drejtësisë të ndara janë edhe ndalimi i autorit të kryejë vepra penale dhe riedukimi i tij dhe ndikimi edukativ mbi të tjerët për të mos kryer vepra penale ( neni.32)

---

<sup>43</sup> Vlado Kambovski, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Shkup, 2016, fq.889

## KAPITULLI I DYTË

### 2.1 KONVENTAT NDËRKOMBETARE MBI EKZEKUTIMIN E DËNIMIT ME BURG

Korniza juridike i përfshin edhe standardet ndërkombëtare për sjellje me personat e dënuar, statusi i të cilëve ka filluar me *rregullat standarte minimale për sjellje me të burgosur* e miratuar në Kongresin e Parë të OKB – preventiva e krimit në Gjenevë më 1955. Zhvillimi i normave ndërkombëtare dhe i standarteve sot e ka arritur shkallën e *normativës ndërkombëtare komplekse* në të gjitha aspektet e sistemit të burgut: hapësirën, higjienën, shëndetësinë dhe standardet tjera, regjistrimin, kategorizimin e personave të dënuar, trajtimin punues, ushqimin, sportin etj.<sup>44</sup> Për sistemin tonë penitenciar janë relevante edhe *rregullat evropiane të burgut* nga Komiteti i Ministrave të KE i vitit 1987.

Për KPT-në, dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të dënimit të tijë ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë. Periudha minimale e nevojshme për të shërbyer para se një i burgosur të përfitojë së pari nga lirimi me kusht ndryshon nga vendi në vend; më e ulëta është 12 vjet (p.sh. Danimarka dhe Finlanda) dhe 15 vjet (p.sh. Austria, Belgjika, Gjermania, Zvicra) dhe më e larta 40 vjet (p.sh. Turqia, në rastin e disa krimeve më të rënda) Shumica e vendeve që zbatojnë dënime me burgim të përjetshëm kanë një periudhë minimale prej 20 deri në 30 vjet.<sup>45</sup> Në juridiksionin e Mbretërisë së Bashkuar, periudha minimale për të vuajtur në burg përcaktohet në kohën e dënimit nga ana e trupit gjykues; ligji nuk parashikon një periudhë absolute minimale në këtë drejtim. Disa vende të tjera (p.sh. Bullgaria, Lituania, Malta, Holanda dhe për krime të caktuara, Hungaria, Republika Sllovaqe dhe Turqia) nuk kanë një sistem të lirimit me kusht për të burgosurit e dënuar me burgim të përjetshëm, prandaj dënimi me jetë mund të nënkuptojë fjalë për fjalë jetën (shih edhe paragrafin 73). Në anën tjetër, vlen të përmendet se në vend të kësaj, për krimet më të rënda kanë dënime të gjata të caktuara zakonisht duke filluar nga 20 në 40 vjet. Numri më i madh i shteteve anëtare të Këshillit të Evropës

---

<sup>44</sup> V.Kambovski&I.Zejneli, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018,fq.277

<sup>45</sup> Statistikat Penale Vjetore të Këshillit të Evropës (SPACE) 2004.8 dhe 2014.7.

nuk kanë burgim të përjetshëm në librin e statutit .<sup>46</sup> Gjatë gjithë historisë, burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur, i pandashëm me dënimin me vdekje dhe progresivisht është bërë dënim alternativ për krimet më të rënda. Megjithatë, qëllimi fillestar i këtij zëvendësimi nuk ishte që të zbutej gjendja e personit të dënuar. Përkundrazi, pikëpamja mesjetare, e cila vazhdoi për shumë shekuj, ishte se burgimi me jetë në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin në vetmi do të shihej nga shkelësit si një alternativë më e keqe se vdekja. Në të njëjtën mënyrë, njëri nga argumentet për mbajtjen e dënimit me vdekje ishte pikërisht se burgimi i përjetshëm me punë të rëndë ishte aq i vështirë se do të shkaktonte më shumë vuajtje për individin në fjalë dhe të ishte më mizor sesa dënimi kapital. Nga perspektiva e sotme, pikëpamja që personat që e vuajnë dënimin me burgim të përjetshëm (ose madje çdo dënim tjetër) duhet të marrin dënim shtesë nga ashpërsia e kushteve në burg është haptazi e papranueshme.<sup>47</sup>

Megjithatë, një këndvështrim i tillë ende është i ngulitur thellë në opinionin publik në shumë vende evropiane. Koncepti i burgimit të përjetshëm u prezantua në vitet 1990 në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës, pas ratifikimit të Protokollit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që hiqte dënimin me vdekje. Ekzekutimi i fundit në një shtet anëtar të Këshillit të Evropës u zhvillua më 1997 dhe, që nga viti 2013, Evropa ka qenë zonë e lirë prej dënimit me vdekje me ligj (me përjashtim të Bjellorusisë).<sup>3</sup> Megjithatë, në shumë vende është konsideruar se publiku do të përkrahte heqjen e dënimit me vdekje vetëm nëse zëvendësimi i tij konsiderohej mjaftueshëm ndëshkues. Rrjedhimisht, personave të dënuar me vdekje iu ndryshuan dënimet në burgime të përjetshme, por duket se ka pasur pak planifikime të detajuara në lidhje me zbatimin e burgimeve të përjetshme. Njëkohësisht, gjatë 25 vjetëve të ekzistencës së KPT-së, ka pasur një rritje të shënuar në numrin e dënimeve me jetë të shqiptuara. Kjo mbase kryesisht është rezultat i dy faktorëve, heqjes ose pezullimit të dënimit me vdekje në të gjithë Evropën dhe të politikave të dënimit në të gjitha shtetet anëtare lidhur me krimet e rënda.<sup>48</sup> Statistikat e fundit tregojnë se ka pasur gjithsej rreth 27.000 të burgosur me dënim me burgim të përjetshëm në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në vitin 2014. Në bazë të një mostre prej 22 vendeve për të cilat janë në dispozicion të dhëna relevante për një periudhë më të gjatë, numri i të burgosurve me dënim me burgim të përjetshëm është rritur

---

<sup>46</sup> Për shembull, Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Portugalia, San Marino, Serbia, Sllovenia dhe Spanja. Më tej, në praktikë, dënimet me jetë nuk janë zbatuar kurrë në Islandë a Lihtenshtajn.

<sup>47</sup> Në disa vende (p.sh. Çekia, Lituania dhe Republika Sllovaqe), të burgosurit e përjetshëm duhet të shërbejnë një periudhë të caktuar (mes 10 dhe 15 vjet) në një njësi e veçantë para se të mund të transferohen në një njësi të zakonshme të burgimit ku mund të shoqërohen me të burgosurit e tjerë.

<sup>48</sup> Shih *Vinter and Others v. the United Kingdom* [GC], nr. 66069/09, 130/10 dhe 3896/10, 9 korrik 2013.

për 66% nga viti 2004 deri më 2014. Më tej, më 2014, në shtetet e ndryshme anëtare të Këshillit të Evropës (veçmas në Mbretërinë e Bashkuar (Angli dhe Uells), Gjermani, Itali dhe Zvicër) ka pasur rreth 7500 të burgosur që mbaheshin në paraburgim të pacaktuar për arsye të sigurisë ose mbrojtjes publike. Disa nga vendet e lartpërmendura kanë arritur të kuptojnë nevojën për t'i përgatitur të burgosurit me jetë për lirim. Këto vende, si dhe ato që hoqën dënimin me vdekje shumë më herët, kanë vendosur masa gjyqësore, kuazi-gjyqësore, administrative ose ekzekutive për shqyrtimin e lirit të të burgosurve me dënim me burgim të përjetshëm në baza individuale. Janë zhvilluar regjime për ta adresuar sjelljen individuale të të burgosurve, duke u ofruar arsimim dhe punë. Më tej, janë nxitur kur është e mundur kontaktet me botën e jashtme, veçmas me familjet, si dhe agjencitë publike dhe bamirëse të jashtme, që janë të angazhuara për ta siguruar përparimin e tyre për gjatë dënimit. E gjithë kjo shërben për t'ua ruajtur "njerëzimin" atyre gjatë dënimit dhe për t'i përgatitur për lirim. Menaxhimi i të burgosurve me dënim me burgim të përjetshëm paraqet sfida për administratën e burgjeve që të mbajë atmosferë pozitive, veçanërisht në dekadën e parë të një burgimi të përjetshëm, por po ashtu ndërsa disa prej këtyre të burgosurve lëvizin drejt moshës së vjetër. Përvoja e këtyre shteteve ofron një burim të mirë njohurish në propozimin e teknikave për ta ruajtur respektin për të drejtat e të burgosurve me që përballen me dënime të papërcaktuara, edhe pse papërcaktueshmëria në vetvete, sado që mund të zgjasë, krijon presione të veçanta psikologjike për të burgosurit. Çështja e dënimit me vdekje ka lëvizur qartë në arenën e të drejtave të njeriut dhe nuk pranohet më thjesht si një çështje e politikës kombëtare të së drejtës penale.<sup>49</sup> Është argumentuar se përjashtimi i dënimit me vdekje nga gjykatat ndërkombëtare për krimet më të rënda të imagjinueshme sugjeron që tani nuk ka asnjë krim aq serioz sa të garantojë dënimin me vdekje.<sup>50</sup> Çështja e dënimit me vdekje shoqërohet me dy norma themelore të të drejtave të njeriut: e drejta e jetës dhe mbrojtja nga dënimet mizore, çnjerëzore dhe degraduese. Të dy normat mund të gjurmojnë rrënjët e tyre te instrumentet e shkëlqyera të ligjit kushtetues anglo-amerikan. Garancia kundër "dënimeve mizore dhe të pazakonta" u përcaktua në projektligjin anglez të të drejtave të vitit 1689. <sup>51</sup>Ishte synuar për disa nga shoqëruesit më barbarë të ekzekutimit që karakterizuan Stuart Anglinë, të tilla si vizatimi dhe kuartingu, zhvendosja ndërsa ishte gjallë dhe amputimi. "E drejta për jetën"

---

<sup>49</sup> William A Schabas, *The Abolition of the Death Penalty in International Law* (Third Edition: Cambridge UP, 2002), fq. 373

<sup>50</sup> Po aty.

<sup>51</sup> W. & M. ch. 2 (1688) (Eng.); see also Anthony F. Granucci, "Nor Cruel and Unusual Punishments Inflicted": The Original Meaning, 57 CAL. L. REV. 839, 839 (1969) (noting that English Bill of Rights of 1689 prohibits cruel and unusual punishments).

ishte pavdekësuar nga fjalët e Thomas Jefferson në Deklaratën e Pavarësisë së 1776. "<sup>52</sup> Revolucionarët amerikanë u përpoqën të mbronin të drejtën për të mos u privuar nga jeta "pa një proces të rregullt ligjor", një njohje jo aq e heshtur e legjitimitetit të dënimit kapital.<sup>53</sup> Nga një këndvështrim historik, asnjëra prej këtyre normave nuk mund të konsiderohet se sfidon ndëshkimin kapital. Megjithatë, në formulimin e tyre më modern, të dyja këto të drejta kanë shërbyer për të kufizuar dhe në disa raste për të ndaluar dënimin me vdekje. "Varja nuk është një makinë e vdekjes, por është një simbol i terrorit, mizorisë dhe shpërfilljes ndaj jetës; emërtues i përbashkët i kësaj egërsie primitive, fanatizmi mesjetar dhe totalitarizmi modern. Ajo qëndron për gjithçka që njerëzimi duhet ta refuzojë, nëse aspiron mbijetimin e krizës së tanishme".

## 2.2 Ligjet vendore për ekzekutimin e dënimit me burg

Përmes formës së prerë vendimi gjyqësor merr përmbajtjen përfundimtare, kurse procedura penale përfundimin final. Plotfuqishmëria formale do të thotë se vendimi i gjykatës nuk mund të atakohet me mjete të rregullta juridike. Plotfuqishmëria materiale do të thotë pamundësi e zhvillimit të procedurës së re penale për të njëjtën vepër penale. Në procedurën penale të dy llojet e cekura të plotfuqishmërisë vijnë në të njëjtin moment. Forma e prerë apo plotfuqishmëria arrijnë vetëm në aspektin e shprehjes apo dispozitave të aktgjykimit, respektivisht aktvendimit, derisa arsyetimi nuk hynë në fuqinë ligjore. Me dispozitat juridike duhet të rregullohet dhe sigurohet që vendimi gjyqësor i nxjerrë në procedurën penale të ekzekutohet kur për këtë të plotësohen kushtet ligjore. Me fjalë tjera procedura penale është e drejtuar në nxjerrjen e llojeve të ndryshme të vendimeve, sidomos të aktgjykimit me hyrjen në fuqi e të cilit kuptohet se ngjarja konkrete penale është zgjedhur në mënyrë përfundimtare.

Në aspektin e ekzekutimit ai paraqet realizimin e kërkesës penale juridike të përcaktuar gjatë gjykimit dhe përmbajtur në vendimin e plotfuqishëm gjyqësor, gjegjësisht realizimin e vendimit i cili është nxjerrë gjatë procedurës penale. Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria sipas rregullit vijnë në të njëjtën kohë. Aktvendimi gjyqësor nuk mund të ekzekutohet para se të hyjë në fuqi. Dënimi me burgim mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe këtë vetëm atëherë kur është i përcaktuar me ligj, për llojin e caktuar të veprave penale edhe nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë por jo edhe më i

<sup>52</sup> Shiko, THE DECLARATION OF INDEPENDENCE para. 2 (U.S. 1776).

<sup>53</sup> Shiko, Callins v. Collins, 510 U.S. 1141, 1141 (1994) (Blackmun, J., dissenting) (noting that Constitution allows capital punishment provided there is due process of law); Gregg v. Georgia, 428 U.S. 153, 177 (1976)

gjatë se 20 vjet [neni 38 i ligjit penal të Kosovës] shqipohet në vjet të plotë dhe muaj të plotë dhe gjerë më 6 muaj edhe në ditë të plota. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim gjer në 3 muaj mund të urdhëroj që ai dënim të zëvendësohet me dënim në të holla apo edhe në pajtim me të dënuarin edhe në punë me dobi shoqërore. Te gjitha legjislacionet penale e njohin dënimin e privimit nga liria – burgimin. Ky dënim konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes dhe qarkullimit personit të gjykuar për një kohë të caktuar. Ky dënim është i vetmi dënim i privimit nga liria me të cilin realizohet mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe arrihet risocializimi i delikuentit. Nga ky këndvështrim ky dënim paraqitet si dënimi themelor dhe më i rëndësishmi në sistemin e dënimeve. Ky lloj i dënimit është i paraparë për një numër të madh të veprave penale si dënimi i vetëm, por në alternacion me dënimin me gjobë. Dënimi i privimit nga liria [burgimi] konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes dhe qarkullimit, kryerësit të veprës për kohën e caktuar të përcaktuar me aktgjykim të gjykatës. Në të gjitha legjislacionet bashkëkohore ky dënim zë vendin qendror. Numri më i madh i veprave penale është i përfshirë me këtë dënim ngase ky dënim ofron mundësi më të mëdha që të realizohet, qëllimi i dënimit i cili konsiston në riedukimin dhe risocializimin e të gjykuarit dhe kthimin e sërishëm të tij në binarët normale jetësore. Dënimi i privimit nga liria është inkorporuar në të drejtën penale me propozim të Bekaries. Këtë lloj të dënimit më herët e futi ligji penal francez i vitit 1791 nga i cili më vonë e mori edhe kodi penal i vitit 1810, ku më pas edhe kalon – përfshihet edhe në legjislacionet tjera . Mbyllja e cila gjerë atëherë zbatohet si masë kishte karakter të sigurimit të prezencës së kryerësit të veprës në mënyrë që në të të ekzekutohej ndonjë masë tjetër ndëshkuese si shkaktimi i lëndimeve trupore apo edhe vrasja. Në krahasim me dënimet trupore të cilat konsistojnë në mundime, tortur, lëndime trupore gjë që ka lënë pasojë të thella në invaliditet, futja e dënimit me burgim paraqet kthesë të madhe dhe progres në këtë fushë. Në teorinë e së drejtës kritikë të vecant kanë përjetuar dënimet e privimit nga liria në kohë zgjatje deri në 6 muaj, të ashtuquajturat dënimet me burgim të shkurtër. Duke filluar nga perfaqësuesit e shkollës pozitive diskutimi vazhdon mbi arsyeshmërinë e zbatimit të këtyre llojeve të dënimeve.

Kundër shqiptimit të dënimeve me burgim të shkurtër paraqitet me arsytet në vijim ;

- 1] Dënimet me burgim të shkurtër nuk janë funksionale për realizimin e prevencionit special dhe atij gjeneral, ngase nuk mundën të veprojnë në mënyrë efikase as në kryerësit të veprës e as në kryerësit potencial ngase këta të fundit nuk e kuptojnë seriozisht as si vërejtje morale e as si mjet të frikësimit.
- 2] Pas zgjatjes së shkurtër të këtyre dënimeve nuk ekziston mundësia e zbatimit të një tretmani serioz edukativo pedagogjik ndaj të dënuarit i cili do të ishte i mjaftuar për realizimin e risocializimit dhe

riedukimit.

3] Dënimi i shkurtë me burgim “ prodhoj “ shumë pasoja të dëmshme për të dënuarin ngase zbatimi i këtij lloji të dënimit ndaj kryerësit stigmatizon ata, vihet vula e gjykueshmërisë në kryerësin e veprës penale gjë që ndikon negativisht në statusin e tij shoqërorë. Ai ndërpret jetën familjare, mund të ndodhë që të ndërpritet edhe marëdhënia e punës së tij. Kjo thënë shkurtë do të thotë që pas burgimit të shkurtë,privimit të shkurtë nga liria mund të rezultojnë shumë pasoja të dëmshme per kryesin e veprës penale të natyrës morale materiale profesionale e shoqërore.

4] Mbyllja në kohë të shkurtë stimolon rikthimin. Ky dënim më së shpeshti u shqiptohet delikuentëve primar të cilët në burg i janë të nënshtruar ndikimeve të dëmshme të recidivistëve dhe delikuentëve profesionistë. Dënimet e shkurtëra me burgim shpesh edhe quhen “seminari i kriminalitetit”

5] Dënimi afatshkurtë me burgim është vecanërisht i dëmshëm për kategorin e caktuar të kryerësit të veprës penale siç janë: delikuentët e mitur, të rriturit e rinj, personalitetet me çregullime psiko sociale, alkoolistët dhe narkomanët. Për kohë të shkurtë sa zgjat ky dënim nuk mund të organizohet tretmani adekuat edukativo- medicinal ndaj këtyre personave.Në anën tjetër bile qëndrimi i shkurtë në burg të personave të tillë mund të reflektoj negativisht në zhvillimin psikik të tyre.

6] Dënimet e shkurtëra me burgim janë skajshmërisht jo ekonomike. Ato i kushtojnë shtrenjtë shoqërisë dhe nuk sjellin asnjë kompenzim material ngase gjatë kohës së qëndrimit në burg nuk mund të organizohet e zbatohet asnjë pune – veprimtari prodhuese etj.

Ne anën tjetër idhtarët të dënimeve me burgim të shkurt paraqesin disa arsye në dobi të mbetjes e këtyre sanksioneve në fuqi. Shumë vërejtje të cilat u adresohen këtyre dënimeve mund tu parashtrihen edhe të gjitha dënimeve tjera të privimit nga liria.Ekzistimin e tyre e arsyetojnë edhe arsyet kriminalo-politike ngase individualizimi i dënimit supozon jo vetëm masa të ndryshme juridiko- penale veçse edhe lartësi të ndryshme të tyre dënimeve ku kjo është e mundshme. Dënimi me burgim të shkurt ka edhe efekt gjeneral preventivë. Numri i madh i qytetarëve ndihen të prekur ngase mund të jenë të dënuar me disa ditë burgim për kryerjen e veprave të palejuara. Për kategori të ndryshme te kryesve të veprave penale siç janë ; personat të cilët sillen në mënyrë të dhunshme, të cilët i shmangen pagesës së obligimeve materiale, alimentacionit, ata të cilët bëjnë delikte në komunikacion, dhe për të tillët dënimet me burgim të shkurtë janë sanksionet më të qëlluara. Edhe struktura e kriminalitetit arsyeton zbatimin e atyre dënimeve ngase mbizotëron kriminaliteti i imët - i lehtë. Edhe teoria edhe praktika pajtohen se këto dënime mund të zbatohen me sukses ndaj kryerësve primarë, të rastit të situatës të kryerësit pa dashje te të cilët nuk egziston prirja kriminogjene. Në raport me këta persona dënimet me

burgim të shkurtë ndikojnë psikologjisht si shok-dënime ngase shumë shpesh këto dënime pranohen me shumë si gjykim moral- shoqëror ndaj aktit të kryer kriminal. Ndaj recidivistëve, të papunëve, bredhsëve, kryesëve me çregullime psikopatike si dhe atyre të cilët janë dhënë pas alkoolit apo substacave narkotike këto dënime janë pa ndikim. Duhet thënë se sot efekti negativ i dënimit me burg zgjidhet me zbatimin e gjerë të lirimit me kusht, gjykimit me kusht dhe qortimit të gjykatës.

Disa vende këto masa i menjanojnë duke vendosur masa para penale siç janë ; puna e dobishme shoqërore, dëmshpërbilimi , mbyllja gjysmë ditore, mbikqyrja e shtuar, përcjellja elektorinke, si dhe masat tjera të cilat nuk ndërpresin lidhjet sociale dhe ato familjare.

Me Ligjin e ri për procedur penale (LPP), i cili zbatohet nga 01.12.2013, u braktis sistemi i deritanishëm i administrimit të procedurës penale me futjen e zgjidhjeve të reja, të cilat kanë të bëjnë, mes tjerash, edhe me administrimin e hetimit nga ana e prokurorit publik, rolin e gjykatësit në procedurën e mëparshme, mundësinë për realizimin e procedurave të shkurtuara dhe parimin e arritjes së marrëveshjes ndërmjet prokurorit publik dhe të akuzuarit për llojin dhe peshën e sanksionit. Koncepti i ri i procedurës penale, në masë të madhe, e ndryshon perceptimin të cilën e kishte deri më tani publiku rreth mbarëvajtjes së hetimeve, rreth realizimit të seancës kryesore dëgjimore gjatë procedurës penale, rreth prezantimit të provave, rreth caktimit të fajësisë. Kështu, u imponua nevoja e domosdoshme për përpilimin e këtij udhëzuesi për gazetarë, për transparencë gjatë procedurave penale, e cila do ta lehtësojë shumë punën e gazetarëve, të cilët raportojnë për procedurat penale, të cilët shkruajnë për punën e gjyqësorit, raportojnë nga terreni për raste ku ka ndodhur vepra penale dhe gjatë të cilave bëhet mbikqyrje, raportojnë për masat juridike të rregullta ose të jashtëzakonshme ose e mbikëqyrin realizimin e sanksioneve penale pas përfundimit fuqiptotë të procedurës penale. Në këtë udhëzues për gazetarë, i cili do të jetë i dobishëm edhe për opinionin më të gjerë publik si studentët, praktikuesit, por edhe qytetarët të cilët, në mënyrë më të thjeshtë, mund të njihen me mbarëvajtjen e procedurave, janë përfshira fazat kryesore të procedurës penale, nga hetimi të cilën tani do ta realizojë prokurori, nëpërmjet rolit të gjykatësit të procedurës së mëparshme (më parë njëhej me emrin gjykatës hetues) e deri në mënyrën e mbajtjes së seancës kryesore, prezantimin e provave, caktimin e fajësisë, shpalljen e vendimeve dhe procedurën ankimore (apelit). Një pjesë e madhe i kushtohet transparencës gjatë procedurës penale, që paraqet edhe motiv kryesor për përpilimin e këtij udhëzuesi. Transparenca si korigjues i të gjitha proceseve, e cila përmes gazetarëve do ta njoftoj publikun saktësisht dhe në kohë për procedurat gjyqësore që realizohen nëpër gjykatat e Maqedonisë, për të cilat ka interesim më të gjerë.



Legjislatura e cila e përkrahën këtë nocion është Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë.<sup>54</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në dispozitat e saja themelore i numëron liritë themelore dhe të drejta e njeriut dhe qytetarit të pranuar me të drejtën ndërkombëtare dhe të caktuara me Kushtetutë, si vlera më relevante kushtetuese-juridike, gjegjësisht, si vlera themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë.<sup>55</sup> Një nga dënimet kryesore që parashikon Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë është edhe dënimi me burgim të përjetshëm i cili është një dënim që jepet vetëm për vepra penale dhe për autorë që paraqesin rrezikshmërin më të madhe shoqërore. Ky dënim ka të bëjë me burgimin e përjetshëm që zgjat gjatë gjithë jeta së tij. Për këtë person nuk ka asnjë lloj favorizimi, përveç në raste të rralla dhe kur sjellja e tij është shembullore. Sipas legjislacioneve në vendin tonë bëhet parashikimi i dënimit me burgim të përjetshëm sipas dispozitës 31 të Kodit Penal dënimi me burgim të përjetshëm jepet vetëm për vepra me rrezikshmëri më të madhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Mirëpo një gjë që kam vërejtur se Kushtetura e Republikës së Maqedonisë e ndalon dënimin me vdekje, por as e parashikon shprehimisht atë në ndryshim nga Dispozitat kryesore kushtetuese që parashikon shprehimisht dënimin me vdekje.

Koncepti për jetesën dhe dinjitetin njerëzorë janë vlera shumë të rëndësishme. Ligji mund të parasheh dënimim me burgim të përjetshëm për veprat e rënda penale në rrethana veçanërisht rënduese ose për veprat penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.<sup>56</sup>

### **2.3 Rregullat minimale standarde të OKB-së, për trajtimin e të burgosurve**

Rekomandimi Nr. R (87) 3 I KOMITETIT TË MINISTRAVE PËR SHTETET ANËTARE MBI RREGULLAT EVROPIANE TË BURGUT (1) Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Europës më 12 shkurt 1987 në mbledhjen e 404 të Zëvendësministrave Komiteti i Ministrave, në përputhje me nenin 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës; Duke pasur parasysh rëndësinë e vendosjes së parimeve të përbashkëta lidhur me politikën penale midis shteteve anëtarë të Këshillit të Evropës; Duke konstatuar se, me gjithë përparimin e konsiderueshëm që është bërë në zhvillimin e dënimeve alternativave me karakter jo-shtrëngues në

---

<sup>54</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Teksti i konsoliduar përmban këto ndryshime në ligj botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" Nr 80/99, Nr. 4/2002 viti, numri 43/2003, numri 19/2004, numri 81/2005, numri 60/06, numri 73/06, numri

7/08, numri 139/08, numri 114/09, numri 51/11, numri 135/11, 185/11, numri 142/12, numri 166/12, numri 55/13, numri 82/13, numri 14/14, numri 27/14, numri 28/14, numri 115/14 dhe Nr 132/14

<sup>55</sup> KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS I-XXX, mundësuar nga <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/Kushtetuta%20e%20RM-se%20Final%20ALB.pdf>

<sup>56</sup> Saliu, Ismet, E drejta penale, Prishtinë, 2003, fq.53

trajtimin e fajtorëve, heqja e lirisë mbetet një sanksion i nevojshëm në sistemet e së drejtës penale; Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të rregullave ndërkombëtarë në praktikën dhe filozofinë e regjimit dhe drejtimit të burgut; Duke konstatuar, megjithatë, se tendencat dhe ndryshimet shoqërore të rëndësishme lidhur me regjimin dhe drejtimin e burgut kanë shtruar kërkesën për të riformuluar “Rregullat minimale standarte për trajtimin e të burgosurve” të Këshillit të Evropës (Rezoluta (73)5) me qëllim që të përkrahen e inkurajohen zhvillimet më të mira dhe të ofrohet një kuadër për përparimin në të ardhmen,<sup>57</sup> Rekomandohen që qeveritë e shteteve anëtare në legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme të udhëhiqen nga parimet e parashtruara në tekstin e Rregullave evropiane të burgut, bashkëngjitur këtij Rekomandimi, me qëllim që të zbatohen në mënyrë progresive, duke vënë theksin në mënyrë të veçantë në qëllimet e parashtruara në parathënie dhe rregullat e parimit themelor në Pjesën e 1, dhe për ta publikuar këtë tekst sa më shumë që të jetë e mundur. Shtesa në Rekomandimi Nr. R (87) 3. Versioni i rishikuar evropian i Rregullave minimale standarte për trajtimin e të burgosurve Këto rregulla janë miratuar për të arritur këto qëllime:

- A. Të vendosin në tërësi të standarteve minimale për të gjitha ato aspekte të administrimit të burgut që janë të rëndësishme për kushtet njerëzore dhe trajtimin pozitiv në sistemet moderne dhe përparimtare;
- B. Të shërbejnë si një stimulues për administratat e burgut që të zhvillojnë politika dhe një praktikë drejtimi të bazuar në parimet e mira bashkëkohore të qëllimit e barazisë;
- C. Të inkurajojnë<sup>58</sup> tek personeli i burgut qëndrime profesionale që pasqyrojnë cilësi të rëndësishme shoqërore e morale të punës së tyre dhe të krijojnë kushte, në të cilat ata mund të kryejnë siç duhet detyrën e tyre në interes të shoqërisë në përgjithësi, të kujdesit për të burgosurit dhe kënaqësisë së tyre profesionale;
- D. Të sigurojnë kriteret themelore realiste mbi bazën e të cilave administratat e burgut dhe organet kompetente për kontrollin e kushteve dhe drejtimit të burgjeve, mund të arrijnë në gjykime të vlefshme mbi realizimin dhe të vlerësojnë përparimin drejt standarteve më të larta.<sup>59</sup>

---

<sup>57</sup> Te drejtat e burgosurve, Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)., mundësuar nga <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/37.%20Te%20drejtat%20e%20te%20Burgosurve%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

<sup>58</sup> Te drejtat e burgosurve, Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)., mundësuar nga <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/37.%20Te%20drejtat%20e%20te%20Burgosurve%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

<sup>59</sup> Po aty.

Duhet theksuar se rregullat nuk përfaqësojnë një sistem model, dhe se në praktikë shumë shërbime evropiane të burgut ndjekin një mënyrë veprimi që qëndron më lart se shumë prej standarteve të parashtruara në rregullat dhe se të tjerë bëjnë përpjekje dhe do të vazhdojnë të përpiqen për të vepruar në këtë drejtim. Kurdoherë që paraqiten vështirësi ose probleme praktike që duhen kapërcyer në zbatimin e këtyre rregullave, Këshilli i Evropës ka mekanizmin dhe përvojën e gatshme për të ndihmuar me këshilla dhe rezultate nga eksperiencia e administratave të ndryshme të burgut brenda sferës së tij.<sup>60</sup>

1. Dënimi i heqjes së lirisë do të kryhet në kushte materiale dhe morale që sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe janë në përputhje me këto rregulla.
2. Zbatimi i rregullave do të bëhet në mënyrë të paanshme. Nuk do të ketë diskriminim për arsye race, ngjyre, seks, gjuhë, feje, mendimi politik ose të tjera, origjinës kombëtare ose shoqërore, statusit të lindjes, atij ekonomik ose tjetër. Secilit të burgosur do t'i respektohen besimet fetare dhe vlerat morale të grupit të cilit ai i përket.
3. Trajtimi i personave nën mbikqyrje do të ketë si qëllim ruajtjen e shëndetit dhe dinjitetit të tyre, dhe për aq sa e lejon kohëzgjatja e dënimit, zhvillimin e ndjenjës së tyre të përgjegjësisë dhe inkurajimin e qëndrimeve a aftësive që do t'i ndihmojnë ata të riintegrohen në shoqëri për të vepruar në përputhje me zbatimin e ligjit dhe të përballojnë vetë jetesën e tyre pas lirit.
4. Institucionet dhe shërbimet penale do të kontrollohen në mënyrë të rregullt nga inspektorë të kualifikuar dhe me eksperiencë, të emëruar nga një autoritet kompetent. Ata do të kenë për detyrë, në veçanti, të mbikëqyrin se në çfarë mënyre dhe mase administrohen këto institucione në përputhje me legjislacionin në fuqi, objektivat e shërbimeve të burgut dhe kërkesat e këtyre rregullave.
5. Mbrojtja e të drejtave individuale të të burgosurve, e në mënyrë të veçantë ligjshmëria e ekzekutimit të masave të ndalimit do të garantohet nëpërmjet ushtrimit të kontrollit në bazë të rregullave kombëtare nga një autoritet gjyqësor ose nga një organ tjetër i emëruar në mënyrë të duhur, i autorizuar për të vizituar të burgosurit, me kusht që të mos jetë pjesë e administratës së burgut.<sup>61</sup>

---

<sup>60</sup> Te drejtat e burgosurve, Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), mundësuar nga <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/37.%20Te%20drejtat%20e%20te%20Burgosurve%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

<sup>61</sup> Te drejtat e burgosurve, Mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian, Qeverisë Italiane dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), mundësuar nga <https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/37.%20Te%20drejtat%20e%20te%20Burgosurve%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

6. Këto rregulla do të vihen në dispozicion të personelit në gjuhët kombëtare; 2. Ata do të vihen gjithashtu në dispozicion të të burgosurve në të njëjtat gjuhë dhe në gjuhë të tjera për aq sa është e arsyeshme dhe e mundshme praktikisht. Burgosja, duke hequr lirinë, përbën një dënim në vetvete. Prandaj me përjashtime të vogla që vuajtjet që ai përmban në vetvete. Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të siguruar që regjimet e institucioneve synojnë dhe kanë rezultat që: <sup>62</sup>

a. të garantojnë që kushtet e jetës janë në përputhje me dinjitetin njerëzor dhe standartet e pranueshme në komunitet;

b. të minimizojnë efektet e dëmshme të burgosjes dhe ndryshimet midis jetës së burgut dhe jetës në liri, të cilat priten të ulin dinjitetin apo sensin e përgjegjësisë personale të të burgosurve;

## **2.4 Konventa kundër torturës**

Republika e Maqedonisë së Veriut është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh e ushtron pushtetin ligjvënës. Zgjedhjet e fundit parlamentare u mbajtën në vitin 2016, ndërsa ato presidenciale në vitin 2014. Në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR) ka deklaruar se zgjedhjet kanë qenë transparente, janë administruar mirë dhe në mënyrën e duhur, por që janë mbajtur në “rrethana të karakterizuara nga mungesa e besimit publik në institucione dhe të establishmentit politik” ndërsa nuk kanë përmbushur disa detyrime të rëndësishme të OSBE-së për një proces zgjedhor demokratik. <sup>63</sup>

Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-së mbi zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 vuri në dukje se zgjedhjet respektuan liritë themelore të qytetarëve, por se nuk kishte ndarje të mjaftueshme midis veprimtarisë partiake dhe shtetërore. Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë. Çështjet e të drejtave të njeriut kanë përfshirë edhe korrupsion të nivelit të lartë. Qeveria gjithashtu bëri hapa për të hetuar, ndjekur dhe dënuar zyrtarët që kanë bërë shpërdorime.

---

<sup>62</sup> Po aty.

<sup>63</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore, ose poshtëruese. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

## **Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke e përfshirë edhe lirinë**

nga:

- a. Privimi arbitrar nga jeta ose vrasje të tjera të paligjshme ose për motive politike Nuk ka pasur raporte që qeveria ose përfaqësuesit e saj të kenë kryer vrasje arbitrare ose të paligjshme.
- b. Zhdukje- nuk ka pasur raporte zhdukjesh, nga ose në emër të autoriteteve qeveritare.
- c. Tortura dhe trajtimet ose ndëshkimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë këto praktika, por ka pasur disa raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të tepërt. Qeveria ka vepruar për të hetuar dhe për të ndjekur pretendime legjitime. Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka raportuar se gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, 2016, ka vepruar në lidhje me 23 ankesa për ushtrim të forcës së tepërt nga efektivë policorë. Shtatë nga këto ankesa janë shpallur të pabaza, ndërsa janë pranuar dy ankesa. Në një rast, kundër një efektiv policie janë ngritur padi penale për përdorim të tepruar të forcës dhe janë ndërmarrë masa disiplinore për largimin e individit nga pozita deri në përfundimin e procedurës disiplinore. Procedura disiplinore ka qenë në vazhdim e sipër në fund të vitit.<sup>64</sup>

Në një rast tjetër, Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar Prokurorinë Publike dhe ka nisur procedurat disiplinore kundër katër efektivëve të policisë. Ministria e Brendshme ka deklaruar se nuk ka pasur prova për 14 ankesat e tjera. Në të njëjtën periudhë, SSP ka pranuar katër ankesa për përdorimin e forcës së tepruar kundër personave të marrë në pyetje dhe në paraburgim.

Hetimet e SSP kanë rezultuar me padi penale kundër një efektiv policie për trajtim të papërshtatshëm. SSP ka konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vazhduar me tre rastet e tjera. Ka ndërmarrë masa disiplinore kundër dy efektivëve për këto vepra. SSP ka vepruar në lidhje me një ankesë të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për përdorimin e tepërt të kimikateve dhe forcës fizike dhe ndalimin e paligjshëm dhe heqjen e lirisë së një gazetari gjatë një proteste publike të 17 qershorit të vitit 2016 para parlamentit. Hetimet kishin treguar se efektivët e policisë kishin ndjekur procedurat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gazetari u arrestua 2 orë me sa duket sepse nuk pranoi të identifikohet. Hetimi ka konstatuar se nuk është përdorur forcë e tepruar në këtë rast. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, dhe, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e

---

<sup>64</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore, ose poshtëruese, pjesa e 1. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984 hyri në fuqi: më 26 qershor 1987 në përputhje me nenin 27 (1) Shtetet palë të kësaj Konvente, duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë. Duke njohur se këto të drejta burojnë nga dinjiteti i lindur i njeriut, duke pasur parasysh se Karta u ngarkon shteteve si detyrë, sidomos neni 55, për të nxitur respektimin universal dhe efektiv të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, duke marrë parasysh nenin 5 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat që të dyja përcaktojnë se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës dhe as trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.<sup>65</sup> Duke marrë parasysh gjithashtu Deklaratën për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Pësimi i Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të tjera Mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 9 dhjetor të vitit 1975. Duke dëshiruar që luftën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ta bëjnë sa më efektive në botë. U morën vesh për sa vijon:

## PJESA E PARË

### **Neni 1.**

Për qëllimet e kësaj Konvente termi “torturë” nënkupton çdo veprim me të cilin personit tjetër i shkaktohen qëllimisht dhembje a vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me qëllim që të sigurojë nga ai ose nga ndonjë person i tretë, informacione ose pohime për ta dënuar për veprën të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e cilit, do lloji, kur dhembjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë që vepron sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij.<sup>66</sup>

Ky term nuk përfshin vuajtjet ose dhembjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre. 2. Ky nen nuk cënon asnjë dokument ndërkombëtar ose asnjë ligj kombëtar që përmban ose mund të përmbajë dispozita të një zbatimi më të gjerë.

---

<sup>65</sup>Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore, ose poshtëruese ,pjesa e 1.Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

<sup>66</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore, ose poshtëruese neni 1 pjesa e 1. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

## **Neni 2**

1. Çdo shtet palë merr masa efektive legjislative, administrative, gjyqësore, ose masa të tjera për të parandaluar veprimet e torturës në cilin,do territor nën juridiksionin e tij.
2. Asnjë rrethanë e jashtëzakonshme, e çfarëdo lloji, qoftë gjendje e luftës ose kërcënim nga lufta, paqëndrueshmëri e brendshme politike apo çdo gjendje tjetër e jashtëzakonshme, nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.
3. Urdhëri i dhënë nga një epror ose autoritet publik nuk mund të shërbejë si shfajësim për torturën.

## **Neni 3**

1. Asnjë shtet palë nuk do të dëbojë, nuk do të prapësojë, e as nuk do të ekstradojë një person në një shtet tjetër ku ka arsye serioze për të besuar sa ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës.
2. Me qëllim të përcaktimit nëse ekzistojnë arsye të tilla, autoritetet kompetente do të marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse duke përfshirë, kudo që është e zbatueshme, ekzistimin e një mister dhunimesh sistematike, të rënda, flagrante ose masive të të drejtave të njeriut në një shtet përkatës.

## **Neni 4**

1. Çdo shtet palë siguron që të gjitha veprimet e torturës të konsiderohen vepra penale nga ligji i tij penal. E njëjta gjë vlen për tentim ushtrimin e torturës dhe për çdo veprim tjetër të kryer nga çdo person si pjesëmarrës në torturë apo në bashkëveprim.
2. Çdo shtet palë do të japë dënime përkatëse për këto vepra penale duke marrë parasysh seriozitetin e tyre.

## **Neni 5**

1. Çdo shtet palë merr masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e përmendura në nenin 4, në raste e mëposhtme:
  - (a) Kur veprat penale kryhen në cilin,do territor(qoftë territor tokësor,ujor,ajror) nën juridiksionin e vet të atij shteti.
  - (b) Kur kryerësi i supozuar është shtetas i atij shteti,

(c) Kur viktima është shtetas i atij shteti, në qoftë se ky shtet konsideron se një gjë e tillë është e përshtatshme.<sup>67</sup>

2. Çdo shtet palë merr gjithashtu masa të tilla të nevojshme për vendosjen e juridiksionit të vet për të gjykuar shkeljet e lartëpërmendura në rastin kur kryerësi i supozuar i tyre ndodhet në cilin do territor nën juridiksionin e tij dhe kur shteti në fjalë nuk e ekstradon në përputhje me nenin 8, në ndonjërin nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë kompetencë penalo-juridike që ushtrohet në përputhje me ligjet e një vendi.<sup>68</sup>

## **Neni 6**

1. Në qoftë se në bazë të shqyrtimit të informacioneve që i ka në dispozicion bindet se rrethanat justifikojnë një gjë e tillë, çdo shtet palë në territorin e të cilit ndodhet personi për të cilin dyshohet se ka kryer një vepër penale të përmendur në nenin 4, siguron paraburgimin e këtij personi ose merr masa të tjera juridike për të siguruar praninë e tij.

Ky paraburgim dhe masat e tjera juridike duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e këtij shteti, por mund të vazhdohen vetëm gjatë kohës së nevojshme për ndjekje penale ose për një procedurë ekstradimi.

2. Shteti i tillë fillon menjëherë një hetim paraprak për të përcaktuar faktet.

3. Çdo person i paraburgosur, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, duhet të ndihmohet për të komunikuar menjëherë me përfaqësuesin e kualifikuar më të afërt të shtetit ku ai është shtetas ose, po qe se është person pa shtetësi, me përfaqësuesin e shtetit ku ai jeton zakonisht.

4. Kur një shtet ka paraburgosur një person, në përputhje me dispozitat e këtij neni, ai njofton menjëherë shtetet e përmendura në nenin 5, paragrafin 1 lidhur me këtë paraburgim dhe me rrethanat që e justifikojnë. Shteti që kryen hetimin paraprak në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, informon menjëherë shtetet në fjalë lidhur me përfundimet dhe u komunikon nëse ka ndërmend të ushtrojë kompetencën e vet.

---

<sup>67</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese neni 5, paragrafi c ,pjesa e 1..Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

<sup>68</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera, çnjerëzore,ose poshtëruese neni5,paragrafi 3,pjesa e 1. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984



## **Neni 7**

1. Shteti palë, në territorin e të cilit është gjetur kryerësi i supozuar i një veprë penale të përmendur në nenin 4, në rast se nuk e ekstradon atë, ua parashtron çështjen në rastin e parashikuar në nenin 5, autoriteteve të veta kompetente me qëllim të marrjes së masave të ndjekjes penale.

2. Këto autoritete marrin vendime në të njëjtat kushte sikurse edhe për çdo vepër penale ordinere të një natyre serioze, sipas të drejtës së këtij shteti. Në rastet e parashikuara në nenin 5, paragrafin 2, standardet e dëshmisë që zbatohen për ndjekjen dhe dënimin nuk janë në asnjë mënyrë më pak të rrepta ose ato që zbatohen në rastet e parashikuara në nenin 5, paragrafin 1.

3. Çdo personi të ndjekur për një nga veprat e parashikuara në nenin 4 i garantohet një trajtim i bazuar në drejtësi në të gjitha fazat e procesit.<sup>69</sup>

## **PJESA E DYTË**

### **Neni 17**

1. Krijohet një Komitet Kundër Torturës (në tekstin e mëtejshëm: “Komiteti”), i cili ushtron funksionet e përcaktuara në tekstin në vazhdim. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe me një kompetencë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët marrin pjesë në cilësi vetjake. Ekspertët zgjedhen nga shtetet palë duke pasur parasysh një ndarje gjeografike të drejtë dhe interesin e pjesëmarrjes në punimet e Komitetit të personave që kanë një përvojë juridike.

2. Anëtarët e Komitetit zgjedhen me votim të fshehtë nga një listë kandidatësh të caktuar nga shtetet palë. Çdo shtet palë mund të caktojë një kandidat të zgjedhur nga radhët e shtetasve të tij. Shtetet palë duhet të kenë parasysh interesin që ekziston për të caktuar kandidatët që janë njëkohësisht anëtarë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut të krijuar në bazë të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe që të kenë vullnet të mirë për të marrë pjesë në Komitetin Kundër Torturës.<sup>70</sup>

3. Anëtarët e Komitetit zgjedhen në mbledhjet dyvjeçare të shteteve palë që i thërret Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, ku kuorumi përbëhet nga dy të tretat e shteteve palë, anëtarë të Komitetit zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të

---

<sup>69</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore,ose poshtëruese neni 7,paragrafi 3,pjesa e 1. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

<sup>70</sup> Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore,ose poshtëruese neni 17,paragrafi 2,pjesa e 2.Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë që janë të pranishme dhe që marrin pjesë në votim.

4. Zgjedhja e parë duhet të bëhet jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes së kësaj Konvente në fuqi. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, u dërgon një letër shteteve palë duke i ftuar që të paraqesin kandidaturat e tyre brenda tre muajve. Sekretari i Përgjithshëm harton një listë me rend alfabetik të të gjithë kandidatëve të propozuar në këtë mënyrë, duke treguar shtetet palë që i kanë caktuar dhe ua dërgon shteteve palë.<sup>71</sup>

5 . Anëtarët e Komitetit zgjedhen për një mandat prej katër vitesh. Ata mund të rizgjedhen edhe për një mandat po se paraqiten sërish. Megjithatë, mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë merr fund pas dy viteve. Kryesuesi i mbledhjes së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni i cakton me short emrat e këtyre pesë anëtarëve mënjëherë pas zgjedhjes së parë.

6. Në qoftë se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqje nga funksioni i tij, apo për çfarëdo arsye tjetër nuk është më në gjendje t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në Komitet, shteti palë që e ka caktuar emëron nga radhët e shtetasve të vet një ekspert tjetër i cili merr pjesë në Komitet për pjesën e mbetur të mandatit, por që këtë ta miratojë shumica e shteteve palë. Ky miratim quhet i siguruar përveç rastit kur gjysma e shteteve palë, ose më tepër, shfaqin një mendim të pafavorshëm brenda gjashtë javësh duke filluar nga çasti kur janë njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për emërimin e propozuar.

## **2.5 Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i R.Maqedonisë**

Sanksionet e caktuara penale, dënimi me burgim, dënimi me gjobë (dënimi me para)ose ndonjë lloj tjetër i masave alternative të caktuara nga gjykata përkatëse për vepra penale të kryera, ekzekutohen kur vendimi gjyqësor me të cilin është caktuar dënimi do të hyjë në fuqi dhe kur nuk do të ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin e të njëjtit për shkak të parashtrimit të çfarëdo lloj ankese ligjore. Procesi është urgjent dhe e realizon gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve penale. Sipas dispozitave të ligjeve në R.Maqedonisë për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve,penale të cilët hyjnë në fuqi kur nuk mund më tej të hidhen poshtë ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrohet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa,

---

<sup>71</sup> Konveta kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore,ose poshtëruese neni17, paragrafi 3 pjesa e 2. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984

vendimi bëhet i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë.<sup>72</sup> Gjykata kompetente për ekzekutimin e sanksioneve penale është gjykata sipas vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar. Sipas Ligjit për ekzekutim të sanksioneve penale, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta kryejë menjëherë, dhe më së voni në afat prej tre ditësh kur vendimi gjyqësorë hynë në fuqi. Procedura për ekzekutimin e të dënuarve në burgim është urgjente<sup>73</sup>. Gjykata për ekzekutimin e sanksioneve penale është e detyruar që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për ekzekutimin e dënimit me burgim menjëherë pas pranimit të vendimit gjyqësor, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh pas pranimit të vendimit gjyqësor. Procedurën për ekzekutimin e sanksioneve penale e udhëheq gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve penale, person të cilin duhet ta ketë çdo gjykatë themelore Gjykata për ekzekutim të sanksioneve penale është e detyruar që të ketë qasje ndaj ekzekutimit të sanksioneve penale menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor Gjykata, në rastin kur i gjykuari nuk paraqitet në ekzekutimin e dënimit me burgim në ditën e caktuar, menjëherë do t'i jep urdhër Ministrisë së Punëve të Brendshme për arrestim të personit të gjykuar, po ashtu, do të kërkojë që përderisa personi i gjykuar fshihet ose gjendet në arratisje, organi të nxjerr ose lëshon urdhër arresti për gjetje të personit të gjykuar për të vuajtur dënimin me burgim të caktuar. Personit të gjykuar personalisht i dorëzohet akt drejtues në të cilën është shënuar dita kur duhet të paraqitet në ndërtesën e përcaktuar të burgut. Me aktin drejtues personi i gjykuar paralajmërohet se përderisa nuk paraqitet në ditën e caktuar, në burg do të futet me forcë Personi i gjykuar prej momentit të marrjes së aktit drejtues për shkuarjen në burg deri me datën kur është shënuar akti për fillim të realizimit të dënimit me burgim duhet të ketë më së paku 8 ditë ,dhe jo më së shumtë 13 ditë kohë. Gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve penale me dorëzimin e aktit drejtues personit të gjykuar njëkohësisht njofton edhe burgun për ditën se kur i dënuari duhet të paraqitet.

Nëse personi i gjykuar, në pajtim me aktin drejtues, nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e dënimit me burgim, burgu për këtë duke mos e zgjatur do të njoftoi gjykatësin për ekzekutim të sanksioneve penale. Personi i dënuar i cili gjendet në liri mund me lutje të kërkojë të shtyjë fillimin e vuajtjes së dënimit me burg, nëse:<sup>74</sup>

1. Gjenden në mjekim mjekësor prej ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësie;
2. Ka pasur rast vdekje ose sëmundje më të rëndë në familjen e ngushtë të personit të gjykuar;

<sup>72</sup> Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i R.Maqedonisë neni10,viti 2016,SHKUP

<sup>73</sup> Po aty.

<sup>74</sup> Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i R.Maqedonisë, neni 13,viti 2016,SHKUP

3. Shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimit të punëve urgjente të papërfunduara ose punëve sezonale, ose punëve të shkaktuara për shkak të ndonjë fatkeqësie natyrore ose ndonjë fatkeqësi tjetër, ndërsa në familje personi i gjykuar nuk ka forcë tjetër punëtore;
4. Personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë punën e caktuar të cilin e ka filluar, dhe për shkak të moskryerjes së asaj pune do të kishte dëm më të madh të dukshëm;<sup>75</sup>
5. Shtyrja e dënimit kur personit të gjykuar i duhet për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose për kalimin e provimeve për të cilët është përgatitur;
6. Së bashku me personin e gjykuar është gjykuar edhe partneri ose anëtarë të tjerë familjar, ose nëse ndonjëri prej tyre po vuan dënim, dhe me arrestimin e të gjithë këtyre personave për shkak të vuajtjes së dënimit do të rrezikohej mirëmbajtja e pleqve, personave të sëmurë ose anëtarë të mitur në familje, ose do të vinte në pikëpyetje ekonominë normale të familjes;
7. Gruaja e gjykuar, fëmija i të cilët është më e vogël se një vjet, ose është shtatzënë, dhe deri në lindje nuk kanë mbetur edhe tre muaj ose
8. Është e nevojshme që personi i gjykuar në kohët të caktuar të kujdeset për edukimin e ruajtjen e fëmijëve ose për përkujdesjen e personave të dobët për të cilët është e detyruar që të kujdeset, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato personave kanë vendbanim ose vendqëndrim. Kundër vendimit të marr me lutje për shtyrje të fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, personi i gjykuar dhe prokurori publik përkatës kanë të drejtë për ankesë deri te këshilli penal në gjykatën kompetente për kryerjen e sanksioneve në afat prej tre ditësh deri në ditën e pranimit të vendimit të shkallës së parë.<sup>76</sup>

---

<sup>75</sup> Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i R.Maqedonisë neni 19,viti 2016,SHKUP

<sup>76</sup> Po aty.

## KAPITULLI I TRETË

### 3.1 POZITA E PERSONAVE TË DËNUAR ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË BURGUN E IDRIZOVËS

Qëllimet e dënimit janë riorsimimi, risocializimi, integrimi, rehabilitimi, pjekuria dhe zhvillimi i personalitetit, në atë mënyrë që nuk do të përsëris rastet të cilat shoqëria (ligji) i dënon. Si të pajtohen këto dy kundërthënie? <sup>77</sup> Burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend nuk i kanë përmbushur standardet ndërkombëtare dhe në disa raste, sipas Raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) <sup>78</sup> të Këshillit të Evropës të vitit 2017, i bazuar në vizitën e vitit 2016, kushtet mund të përshkruhen si mizore, çnjerëzore dhe degraduese. Korrupsioni, keqtrajtimi nga rojet e burgut, dhuna midis të burgosurve, kushtet e pasigurta dhe johigjienike, stafi i pamjaftueshëm dhe trajnimi i pamjaftueshëm i rojeve dhe personelit mbeten probleme serioze, veçanërisht në burgun e Idrizovës, i cili përfshin më shumë se tre të pestat e popullsisë së burgut të vendit. Kushtet fizike: Vendi ka 11 burgje dhe tre objekte korrektuese për të mitur; në shtatë burgje janë vendosur edhe të paraburgosur në pritje të gjykimit. Sistemi i burgjeve ka vazhduar të përballlet me mungesë fondesh, trajnim joadekuat të efektivëve dhe korrupsion. Disa të burgosur të liruar nga burgju rishtazi, nga rastet e profilit të lartë kanë pretenduar se ishin keqtrajtuar ndërsa kanë qëndruar në burg. Më 17 prill, Komisioni Evropian (KE) lëshoi raportin e vitit 2018 për Maqedoninë e Veriut, i cili vuri në dukje se numri i ulët i ankesave lidhur me keqtrajtimin, të pranuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, nuk e ka paraqitur gjendjen e vërtetë si dhe ka treguar se mungon besimi në procedurat e ankimit. Përveç kësaj, ajo e ka quajtur situatën në sistemin e burgjeve "kritike" për shkak të mungesës së mjeteve financiare, mungesës së stafit, keqmenaxhimit dhe mbipopullimit. Sipas Avokatit të Popullit, mbipopullimi kishte rënë për shkak të përmirësimeve në burgun e Idrizovës dhe një ligj amnistie të zbatuar në janar që ka zbutur mbipopullimin duke liruar 800 të burgosur me dënime prej më pak se gjashtë muajsh. Me amnistinë është vendosur gjithashtu një reduktim i dënimit prej 30 përqind për 3,000 të burgosur të

---

<sup>77</sup> Macanoviq & Nadareviq 2014 fq.12

<sup>78</sup> Raporti i KPT për Maqedoninë ,per trajtimin e të burgosurve për vitin 2017

tjerë. Ligji nuk ka përfshirë personat e dënuar për krime të rënda, si vrasje, përdhunim, krime seksuale ndaj fëmijëve, ose terrorizëm. Që nga 19 shtatori, Avokati i Popullit besonte se kishte ende nevojë për përmirësime të dukshme të kushteve në burgje. Avokati i Popullit harton raport vjetor i cili përfshin të dhëna mbi kushtet në burgje. Raporti më i fundit është lëshuar më 29 mars ku thuhet: "mbipopullimi dhe kushtet e këqija në institucionet ndëshkuese- korrektuese mbetet një problem serioz.<sup>79</sup> Me këtë është shkelur dinjiteti njerëzor i personave të privuar nga liria. Sistemi i kujdesit shëndetësor të burgjeve ka mbetur edhe më tej jofunksional dhe kjo shkon në dëm të personave të dënuar dhe të personave në paraburgim të cilët madje nuk kanë pasur as sigurim shëndetësor. Kjo situatë ka ndikuar mbi pakënaqësinë e personave të dënuar dhe të paraburgosur, por gjithashtu ka rritur dyshimet lidhur me trajtimin efektiv dhe shërbimet e tjera shëndetësore në institucionet ndëshkuese. Sektori i sigurisë, Departamenti për ri-socializim, si dhe shërbimi shëndetësor nuk kanë qenë të pajisur as me personel dhe as me profesionalizëm". Në vlerësimin e vitit 2016, KPT-ja ka vënë re se anekset sanitare ishin në një "gjendje të tmerrshme (të ndyra, me erë të keqe, të dëmtuara dhe me rrjedhje), shumë nga dushet nuk funksiononin dhe nuk kishte pothuajse fare furnizim me ujë të ngrohtë". KPT ka vërejtur se ngrohja ka punuar vetëm disa orë në ditë dhe se kujdesi shëndetësor në burgun e Idrizovës ka qenë i pamjaftueshëm, ku shumë të burgosur kanë vuajtur nga kafshimet e insekteve dhe infeksionet si zgjebja. Personeli i pamjaftueshëm dhe trajtimi joadekuat i rojeve të burgut dhe personelit kanë mbetur probleme në të gjitha objektet. Administrimi: Avokati i Popullit ka konstatuar se hetimet e autoriteteve korrektuese mbi pretendimet për keqtrajtim dhe abuzimin e të burgosurve kanë qenë përgjithësisht të pa efektshme. Numri i personave në burgje pa dokumente identifikimi ka shënuar rënie. Monitorimi i pavarur: Ligji mundëson që personat në paraburgim të vizitohen nga mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit të KPT-së dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me leje paraprake nga gjykatësi hetues. Qeveria paraprakisht u ka lejuar organizatave të pavarura humanitare, siç është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend, qasjen deri te të burgosurit e dënuar me kërkesë të të burgosurve, por në nëntor Komiteti kishte firmosur memorandum për mirëkuptim me Qeverinë për të siguruar qasje të pakufizuar.<sup>80</sup> Avokati i Popullit i ka vizituar rregullisht (një herë në muaj) burgjet në vend dhe i ka hetuar pretendimet e besueshme për kushte problematike. Përmirësime: Ministria e Drejtësisë ka deklaruar

---

<sup>79</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për trajtimin e të burgosurve për vitin 2018

<sup>80</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për trajtimin e të burgosurve për vitin 2017

se faza e parë e përmisimeve në burgun e Idrizovës ka përfunduar në gusht, duke rritur kapacitetin e burgut për 546 persona të tjerë, në gjithsej 1,346. Përmirësimet kanë përfshirë ndërtimin e tri godinave, një me kapacitet prej 294 të burgosur dhe dy objekte për 252 të burgosur në pjesën gjysmë të hapur.<sup>81</sup>

Janë blerë mobilje, kuzhina çaji, lavanderi, palestër, si dhe dyshekë, çarçaf dhe pajisje sigurie.

a. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar Ligji ndalon arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikon të drejtën e çdo personi për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij në gjykatë, ndërsa qeveria përgjithësisht i ka respektuar këto kërkesa. Roli i policisë dhe aparatit të sigurisë Ushtria është përgjegjëse për sigurinë e jashtme, ndërsa Presidenti është komandanti suprem i Armatës. Policia kombëtare ruan sigurinë e brendshme, duke përfshirë edhe migracionin dhe mbrojtjen e kufijve, si dhe i raporton Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përkundër pengesave nga raste të korrupsionit dhe presionit politik, Ministria e Brendshme ka bërë disa përparime në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së saj. Autoritetet civile kanë kontrollin efektiv mbi ushtrinë dhe Ministrinë e Brendshme, kurse qeveria ka mekanizma efektivë për të hetuar dhe dënuar abuzimin. Megjithatë, Avokati i Popullit beson se mosndëshkimi i efektivëve të policisë mbetet problem. Deri më 28 gusht, në zyrën e Avokatit të Popullit janë dorëzuar 11 ankesa kundër efektivëve të policisë për përdorim të paligjshëm ose të tepërt të forcës, krahasuar me nëntë ankesa në vitin 2017.

Në një rast, zyra nuk ka mundur të konstatojë faktet, duke pasur parasysh se kishte kaluar shumë kohë nga incidenti deri te denoncimi. Në rastin e dytë, zyra ka konstatuar se përdorimi i forcës nuk ka qenë në përputhje me rregulloren e institucionit. Deri më 28 gusht, zyra e Avokatit të Popullit ka raportuar se kishte pranuar gjithsej 163 ankesa nga të burgosurit.<sup>82</sup> Në tri ankesa, të burgosurit kanë shprehur pretendimet për torturë nga rojet e burgut. Një hetim ishte i pazgjidhur; dy të tjerat nuk kanë dhënë rezultate konkrete bazuar në dëshmitë që i ka pasur Avokati i Popullit.

Deri më 28 gusht, Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve ka marrë dy njoftime për përdorimin force ndaj të burgosurve nga ana e policisë së burgut, kundrejt 14 sosh në vitin 2017. Më 12 prill, parlamenti solli tre ligje: Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligjin për themelimin e Agjencisë Teknike Operative (ATO) si organ përgjegjës për përgjimet e ligjshme në vend dhe Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve. ATO pritet të jetë lehtësuesi teknik i operacioneve të përgjimit të

---

<sup>81</sup> Po aty

<sup>82</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për trajtimin e të burgosurve për vitin 2017

ligjshëm të komunikimeve, që do veprojnë me buxhet të pavarur nga Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) e Ministrisë së Brendshme. ATO ka filluar me punë më 20 nëntor, kabineti i Kryeministrit ka miratuar modelin e propozuar dhe planin e zbatimit të rreformës së sistemit të sigurisë dhe zbulimit. Kabineti e ka ngarkuar Ministrinë e Brendshme, për koordinimin e zbatimit të rreformës, në bashkëpunim me institucionet e interesuara. Përveç hetimit të pretendimeve për keqtrajtim nga efektivet e policisë, Sektori për Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Brendshme ka zhvilluar të gjitha hetimet e brendshme mbi pretendimet për forma tjera të sjelljes së keqe të policëve. Sektori, gjatë hetimeve, ka të drejtën e shqiptimit të sanksioneve administrative, siç është suspendimi i përkohshëm nga puna. Sektori nuk mund të marrë masa disiplinore, të cilat kërkojnë një vendim nga një komision disiplinor dhe as të vendosë ,sanksione penale më të rënda, të cilat kërkojnë veprime gjyqësore.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve Ligji parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalimin të të dyshuarve bazuar në prova, dhe policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbytur këtyre procedurave. Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë.

Pas ngritjes së padisë, periudha maksimale e paraburgimit është dy vite. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, SSP e Ministrisë së Brendshme ka pranuar katër ankesa për pretendime për përdorimin e tepruar të forcës gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe personave në paraburgim. SSP ka ngritur padi penale kundër një efektiv policie për trajtim të papërshtatshëm policor dhe ka hedhur poshtë tre të tjera për shkak të mungesës së provave. Ekziston sistemi i dorëzatisë. Ligji i lejon të pandehurit<sup>83</sup> të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por autoritetet nuk kanë informuar gjithmonë të ndaluarit ashtu siç duhet për të drejtën e tyre dhe nuk kanë lejuar gjithmonë që të konsultohen me një avokat para paraqitjes në gjykatë.<sup>84</sup>

Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë kërkesë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim. Paraburgimi: Në

---

<sup>83</sup> Raporti i Avokatit të Popullit për trajtimin e të burgosurve për vitin 2015

<sup>84</sup> Po aty.



të shumtën e rasteve, gjykatat kanë respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit. Gjatë vitit, 2017 numri i urdhrave të gjykatës për paraburgim ka rënë në mënyrë të konsiderueshme krahasuar me vitet e kaluara. Në shumicën e rasteve, Prokuroria Publike dhe Prokuroria Speciale kanë kërkuar, ndërsa gjykata ka vendosur masën e parandalimit, në vend të urdhrit për paraburgim të të dyshuarve dhe të pandehurve për të parandaluar rrezikun e ikjes së dëshmitarëve, manipulimit të provave dhe përsëritjen ose kryerjen e krimeve të reja. Mohimi i gjykimit të drejtë publik Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom.<sup>85</sup> Qeveria ka treguar respekt më të madh për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit krahasuar me vitet e kaluara.

Pavarësia e kufizuar gjyqësore, politizimi i organit mbikëqyrës gjyqësor dhe financimi i pamjaftueshëm i gjyqësorit, megjithatë, kanë vazhduar të pengojnë punën dhe efektivitetin e gjyqësorit. Sipas raportit të KE-së të 17 prillit, gjyqësori në vend ka arritur përparim të caktuar në rritjen e pavarësisë. Shteti ka sjellë një strategji të re të besueshme për reformën gjyqësore dhe pjesët kryesore të legjislacionit janë ndryshuar në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe "Prioritetet e Reformave Urgjente " të BE-së. Prokuroria Speciale është përballur me më pak pengesa nga gjykatat. Raporti i KE-së gjithashtu ka arritur në përfundimin se nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar rekomandimet e kryesore dhe për të siguruar që gjyqësori të mund të funksionojë pa ndikim të pajustificuar.<sup>86</sup>

***Burgimi i përjetshëm*** është dënim i veçantë që jepet për veprat më të rënda penale të parashikuar me ligj për të cilat është paraparë dënim me burgim prej 20 vjetësh (n.35.p.2). Ky dënim nuk mund të përshkruhet si dënim i vetëm kryesor (n.35.p.3). Nga dispozita e mëhershme del se ajo mund të përshkruhet si dënim alternativ vetëm me dënim me burgim deri në 20 vjet. Alternativa për burgimin e përjetshëm është edhe dënimi me burgim deri në 40 vjet (n.35 p.1). Ligji në mënyrë eksplicite e përjashton shqiptimin e këtij dënimi kryerësit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet (n.35 p.4). Burgimi i përjetshëm u paraqit në legjislacionin tonë penal në vitin 1996 për të plotësuar një zbrazëtitirë e krijuar me ndalesë kushtetuese për *shqiptim të dënimit me vdekje*.<sup>87</sup>

---

<sup>85</sup> Raporti i KE për Maqedoninë lidhur me trajtimin e të burgosurve për vitin 2017

<sup>86</sup> Po aty.

<sup>87</sup> n.10 p.2 nga Kushtetuta; *shih Kambovski, 4,20*

### 3.1.1 Fillimi i ekzekutimit të dënimit me burg të përjetshëm

Drejtesia është drejtësi vetëm atëherë kur ajo realizohet deri në fund, që do të thotë atëherë kur shkelësi i ligjit, ta vuaj dënimin, e tij! E drejta për ekzekutim të aktgjykimit (në rastin tonë të sanksioneve penale) është një pjesë integrale e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme.<sup>88</sup> Ky punim, shqyrton kornizën ligjore si në vend ashtu edhe atë ndërkombëtare të zbatueshme për ekzekutimin e sanksioneve penale; punimi po ashtu shqyrton edhe zbatimin e tyre të deritashëm nga ana e institucioneve si dhe ingranazhin e përgjithshëm të procesit të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Përgjithësisht<sup>89</sup> jepet një trajtim analitik dhe vështrime krahasimore të ekzekutimit të sanksioneve penale në Maqedoni, në periudha të ndryshme kohore duke e pasuruar këtë vështrim edhe me statistika dhe raporte të punës së bartësve të ekzekutimit të sanksioneve penale si dhe duke shtjelluar penologjinë përgjithësisht, politikën penalogjike në Maqedoni në periudhën kohore, sistemin e ekzekutimit të sanksioneve penale, burgjet, ndarjen organizimin, funksionimin e tyre, rolin e institucioneve si prokurorisë, gjykatës, policisë në këtë ekzekutim, të drejtat e të provuarve apo të sanksionuarve me sanksione penale. Në vështrimin historik, legjislacioni mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptarë deri në ditët e sotme. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike ideologjike etj.<sup>90</sup> Duke bërë një ndarje të legjislacionit mbi ekzekutimin e vendimeve në: Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile.<sup>91</sup> Në Maqedoni, aktgjykimet si në rastet civile ashtu edhe në ato penale, pasi të marrin formën e prerë, përmbrohen/ekzekutohen nga zyrtarë për ekzekutime në gjykata, që përfshijnë gjyqtarë për ekzekutimin e sanksioneve penale. Në rastet civile, procedura përmbartimore inicohet nga kreditori në mënyrë që të fitojë gëzimin e së drejtës e cila veç se i është njohur në aktgjykim të formës së prerë apo në ndonjë tjetër dokument origjinal. Në rastet penale, ekzekutimi i sanksioneve penale fillon me automatizëm sapo aktgjykimi me të cilin është caktuar sanksioni penal merr formën e prerë dhe nuk ka pengesa ligjore për përmbartim të tij. Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi më i rëndë që mund ti shqiptohet kryerësit i cili ka kryer vepër më të rëndë penale, të kryer në mënyrë rënduese dhe që ka shkaktuar

---

<sup>88</sup> Borislav Petroviq, E drejta e penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006 FSK/S -14/06

<sup>89</sup> Po aty

<sup>90</sup> Po aty

<sup>91</sup> Po aty

pasoja shumë të rënda.<sup>92</sup>

Ky ligj nuk mund të parashih dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një veprë të veçantë penale. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet. Po ashtu dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet edhe personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur 40 vjet nga dënimi me burgim të shqiptuar. Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një vepre penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit).

**Ekzekutimi i aktgjyqimit penal të huaj**<sup>93</sup> kuptojmë rastet kur një personi i është dhënë dënimi në shtetin ku e ka kryer veprën penale dhe ai më pas i dorëzohet shtetit tjetër, zakonisht shtetit shtetësinë e të cilit e ka apo ku e ka vendbanimin e përhershëm me qëllim që atje ta mbaj dënimin. Çështja e ekzekutimit të aktgjyqimit penal të huaj, është rregulluar me normat kushtetuese dhe ligjore të shteteve. Me anë të këtyre normave interne, në procedurë paraprake kërkohet që të konstatohet nëse janë plotësuar kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjyqimit të huaj penal.<sup>94</sup> Kjo procedurë paraprake duhet të konstatoj nëse është bërë parashkrimi i ekzekutimit të dënimit, nëse gjykata vendase më parë ka nxjerrë aktgjykim për atë veprë penale, nëse dënimi është shqiptuar me procedurën e cila i ka respektuar garancitë minimale të gjyqimit objektiv etj. Mirëpo duhet theksuar se me këtë procedurë të shikimit të aktgjyqimit penal të huaj, nuk është e lejuar vërtetësia e provave dhe kualifikimi juridikë, sepse me këtë do të kundërshtohet kuptimi i ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare.<sup>95</sup>

### **3.2 Pranimi i personave të dënuar**

Sipas dispozitave të ligjeve të Maqedonisë për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve penale, të cilët hyjnë në fuqi kur nuk mund të paraqiten ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrahet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa, vendimi bëhet i zbatueshëm

<sup>92</sup> Borislav Petroviq, E drejta e penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006 FSK/S -14/06

<sup>93</sup> Ragaip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016

<sup>94</sup> Ragaip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2016

<sup>95</sup> Po aty,

me skadimin e afatit për ankesë. Gjykata kompetente për ekzekutimin e sanksioneve ,penale është gjykata sipas vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar. Sipas Ligjit për ekzekutim të sanksioneve,penale, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta kryejmë menjëherë, dhe më së voni në afat prej tre ditësh kur vendimi,gjyqesorë hynë në fuqi. Procedura për ekzekutimin e të dënuarve në burg është urgjente.Gjykata për ekzekutimin e sanksioneve,penale është e detyruar që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për ekzekutimin e dënimit me burgim menjëherë pas pranimit të vendimit gjyqesorë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh pas pranimit të tij.Procedura për ekzekutimin e të gjithë sanksioneve,penale e udhëheq gjykatësi per ekzekutimin e sanksioneve ,penale, person të cilin duhet ta ketë çdo gjykatë themelore. Ai mes tjerash vendos për:<sup>96</sup>

1.Referencë për dhënien e dënimit me burgim;

2.Zvarritje të vuajtjes së dënimit me burgim;

3.Ndërpërje të vuajtjes së dënimit me burgim dhe hyrjen në fuqi ndalesën për vuajtje të dënimit me burgim;

4.Vjetërsia e ekzekutimit të dënimit me burgim ose ndalesa për vuajtjen e dënimit me burgim për shkak të vdekjes së personit të gjykuar, informon gjykatën përkatëse për shkak të marrjes së vendimit të duhur;

Gjykata për ekzekutim të sanksioneve,penale është e detyruar që të ketë qasje ndaj ekzekutimit të sanksioneve penale,menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqesorë. Gjykata, në rastin kur i gjykuari nuk u paraqit në ekzekutimin e dënimit me burgim në ditën e caktuar, menjëherë do t'i jep urdhër Ministrisë së Punëve të Brendshme për arrestim të personit të gjykuar, po ashtu, do të kërkojë që përderisa, personi i gjykuar fshihet ose gjendet në arratisje, organi të nxjerr ose lëshon urdhër arresti për gjetje të personit të gjykuar për të vuajtur dënimin me burg të caktuar.Personit të gjykuar personalisht i dorëzohet akti drejtues në të cilën është shënuar dita kur duhet të paraqitet në ndërtesën e përcaktuar të burgut. Me aktin drejtues personi i gjykuar paralajmërohet se përderisa nuk paraqitet në ditën e caktuar, në burg do të futet me forcë.Personi i gjykuar prej momentit të marrjes së aktit drejtues për shkuarjen në burg deri me datën kur është shënuar akti për fillim të realizimit të dënimit duhet të ketë më së paku tetë ditë,por,jo më së shumt 13 ditë kohë. Gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve,penale me dorëzimin e aktit drejtuese personit të gjykuar njëkohësisht njofton edhe burgun për ditën se kur i dënuari duhet të paraqitet. Nëse personi i

---

<sup>96</sup> Закон за Кривичната постапка, Службен весник на РМ бр. 150/2010, бр. 100/2012

gjykuar, në pajtim me aktin drejtues, nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e dënimit me burg, burgu për këtë duke mos e zgjatur do të njoftoi gjykatësin për ekzekutim të sanksioneve penale. Personi i dënuar i cili gjendet në liri mund me lutje të kërkojë të shtyjë fillimin e vuajtjes së dënimit me burg, nëse:

1. Gjenden në mjekim mjekësor prej ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësie;
2. Ka pasur rast vdekje ose sëmundje më të rëndë në familjen e ngushtë të personit të gjykuar;<sup>97</sup>
3. Shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimin e punëve urgjente të papërfunduar ose punë sezonale, ose punëve të shkaktuara për shkak të ndonjë fatkeqësie natyrore ose ndonjë fatkeqësi tjetër, ndërsa në familje personi i gjykuar nuk ka forcë tjetër punëtore;
4. Personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë punën e caktuar të cilin e ka filluar, dhe për shkak të moskryerjes së asaj pune do të kishte dëm më të madh të dukshëm;
5. Shtyrja e dënimit kur personit të gjykuar i duhet për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose për kalimin e provimeve për të cilët është përgatitur;<sup>98</sup>
6. Së bashku me personin e gjykuar është gjykuar edhe partneri ose anëtarë të tjerë familjar, ose nëse ndonjëri prej tyre po vuan dënim, dhe me arrestimin e të gjithë këtyre personave për shkak të vuajtjes së dënimit do të rrezikohej mirëmbajtja e pleqve, personave të sëmurë ose anëtarë të mitur në familje, ose do të vinte në pikëpyetje ekonomin normale të familjes;
7. Gruaja e gjykuar, fëmija i të cilët është më e vogël se një vjet, ose është shtatzënë, dhe deri në lindje nuk kanë mbetur edhe tre muaj ose
8. Është e nevojshme që personi i gjykuar në kohët të caktuar të kujdeset për edukimin e ruajtjen e fëmijëve ose për përkujdesjen e personave të dobët për të cilët është e detyruar që të kujdeset, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato personave kanë vendbanim ose vendqëndrim.<sup>99</sup>

Kundër vendimit të marr me lutje për shtyrje të fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, personi i gjykuar dhe prokurori publik përkatës kanë të drejtë për ankesë deri te këshilli penal në gjykatën kompetente për ekzekutimin e sanksioneve, penale në afat prej tre ditësh deri në ditën e pranimit të vendimit të shkallës së parë. Ankesa zhvat ekzekutimin e dënimit. Këshilli penal është i detyruar që të merr vendim pas ankesës në afat prej tre ditësh pas pranimit të ankesës. Shtyrjen e fillimit të

---

<sup>97</sup> Закон за извршување на санкциите од 29.12.2005 година, измени и дополнувања, 2010/2014/2015. 2017 година

<sup>98</sup> Јавност во кривичната постапка, прирачник за новинари ОБСЕ 2014 година

<sup>99</sup> Јавност во кривичната постапка, прирачник за новинари ОБСЕ 2014 година

ekzekutimit të dënimit me burg mund ta caktojë edhe gjykata përkatëse për vendosje para kërkesës për përmirësimin e procedurës penale (Gjykatën themelore), të parashtruar në shërbim të personit të gjykuar, me kërkesë për rishkrim të jashtëzakonshëm të një vendimi përfundimtar (Gjykata e Lartë) dhe me kërkesë për ndryshim të dënimit me burg në dënim me para, nën kushte të parapara me ligj. Përderisa zgjat sëmundja, gjegjësisht mjekimi, nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar gjendet në mjekim për shkak të ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësia. Për shkak të arsyes specifike (hospitalizim për shkak të sëmundjes së rëndë akute ose varësisë) Ligji lejon lutje për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit mund ta vuaj partneri i tij, familjar nga gjaku në linjën e parë, prindi adoptues, fëmija i adaptua, vëllau, motra ose kujdestari. Personi i gjykuar të cilin i është shtyrë vuajtja e dënimit për këtë shkak është i detyruar që në çdo 30 ditë të dorëzojë fakt të vlefshëm për gjendjen e tij shëndetësore. Më së voni për tre muaj, nëse shtyrja kërkohet për shkak të vdekjes ose ndonjë sëmundje në familjen e afërt të personit të gjykuar; nëse shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimit të punëve urgjente përgjysmë ose sezonale, ose punë të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose ndonjë fatkeqësie tjetër, dhe në familjen e të dënuarit nuk ka forcë të mjaftueshme punëtore; nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë një punë të caktuar të cilën e ka filluar tashmë, dhe për shkak të mos kryerjes së asaj pune do të ketë dënim më të madh; dhe nëse është e nevojshme që personi i gjykuar për kohë të caktuar të kujdeset për edukimin dhe ruajtjen e fëmijëve ose kujdesin e personave të pafuqishëm për të cilët është i detyruar t'i kryejë, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato persona banojnë ose kanë vendqëndrimin. Pas kryerjes së vitit shkollor nëse shtyrja personit të gjykuar i është e nevojshme për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose, gjashtë, muaj nëse shtyrja personit të dënuar i është e nevojshme për shkak të provimeve për të cilët është përgatitur.<sup>100</sup>

### **3.3 Të drejtat e personave të dënuar me burgim të përjetshëm**

Në sistemin modern penitenciar, personat e dënuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë nëpër institucionet penitensiare, gëzojnë disa të drejta dhe liri të garantuara me konventa ndërkombëtare dhe me dispozita të ligjeve pozitive të secilit shtet<sup>101</sup>. Këto të drejta janë parapa dhe precizuar edhe me Rregullat standarde minimale të OKB-së dhe Rregullat Evropiane mbi

<sup>100</sup> Јавност во кривичната постапка, прирачник за новинари ОБСЕ 2014 година

<sup>101</sup> R.Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001

burgun. Sipas dispozitave ligjore në fuqi të Kushtetutës së RM-së, Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe akteve nënligjore, te, burgosurit në institucionet penitensiare kanë disa të drejta që paraqesin një varg të drejtash. Po ashtu personat e dënuar mund të fitojnë edhe disa të leje të veçanta për shkak të vdekjes, të ngjarjeve të rëndësishme familjare dhe në rastet e tjera të arsyeshme, si dhe mund të fitojnë edhe leje shpërblyese dhe shpërblime të caktuara, si rezultat i angazhimit të tyre në punë, të sjelljeve të mira ndaj personelit penitensiar, për rezultatet e arritura në aktivitete të ndryshme brenda institucionit penitensiar etj.

Duke u mbështetur në dispozitat juridike të akteve penitensiare të Republikës së Maqedonisë, praktikën penitensiare, intervistat me personelin penitensiar dhe me personat e dënuar, dhe në të dhënat e tjera të kësaj fushe në vijim do të trajtohen dhe analizohen të drejtat e personave të dënuar. Si të drejta më të njohura të personave të dënuar në sistemin penitensiar janë:

– e drejta në punë, e drejta në pushim, e drejta në sigurim social dhe invalidor, e drejta në arsimim, e drejta në mbrojtje shëndetësore, e drejta në pranimin e vizitave, e drejta e korrespondencës dhe informacionit, e drejta në pranimin e pakove, e drejta në kërkesa dhe ankesa etj., “Personi i dënuar i aftë për punë ka të drejtë dhe obligim të punojë. Të drejtës në punë dhe realizimit të saj i kushtohet rëndësi të madhe në institucionet penitensiare, për arsye se puna është mjet dhe metodë themelore e procesit të riedukimit dhe riintegritimit të personave të dënuar.<sup>102</sup> Qëllimi i realizimit të punës është që ata të fitojnë, të ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre fizike dhe psikike. Personat e dënuar të angazhuar në punë japin deklaratë se vullnetarisht duan të punojnë dhe të kryejnë punët e caktuara. Në bazë të akteve juridike në fuqi, të cilat i referohen pozitës së personave të dënuar në institucionet, del se puna e të dënuarve është një e drejtë dhe obligim i tyre. Dispozitat juridike përmbajnë disa norma që trajtojnë punën e të dënuarve, karakterin e saj, kushtet e punës, shpërblimin e të dënuarve etj. Kështu, sipas neneve 113- 114 të LZSP, “Nga personat e dënuar kerkohet, të punohet konforme aftësive të tyre fizike dhe psikike të cilët konstaton mjeku i institucionit. Për caktimin e angazhimit në punë, duke i pasur mundësitë institucioni do të mbajë llogari për dëshirën e personit të dënuar gjatë kryerjes së punëve të caktuara”<sup>103</sup>

Dispozitat e akteve penitensiare kërkojnë që kushtet e punës së të dënuarve të jenë të ngjashme me ato në shoqërinë e lirë, në mënyrë që të dënuarit të fitojnë aftësi profesionale për riintegrimin e tyre në shoqëri i dënuari mund të punojë brenda njësisive ekonomike të institucionit, por edhe jashtë

<sup>102</sup> R. Halili “Penologjia”, Prishtinë, 2005

<sup>103</sup> Z. Sulejmanov: Penologjia, Shkup, 2000, .

institucionit, ka të drejtë në shpërblim për punën e kryer në institucion. Për realizimin e të drejtës në punë të personave të dënuar, si e drejtë themelore e tyre parashohin dispozitat e Rregullores për llojin, kushtet e kryerjes së punëve me dobi të përgjithshme.<sup>104</sup> Është e drejtë themelore e cila buron nga e drejta e punës Personat e dënuar kanë të drejtë në sigurim pensional dhe invalidor e drejtë që mbështetet në aktet pozitive juridike.

Pra “Personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burgim ju njihet stazhi pensional dhe koha që ato e kalojnë në punë pa ndërprerë me orar të plotë<sup>105</sup>”, nëse nga mjetet e marra u paguhen kontributet e caktuara. Kësisoj, nëse personi i dënuar gjatë vuajtjes së dënimit me burg është sëmurë, apo ka përjetuar ndonjë fatkeqësi, aksident në punë, ose sëmundje profesionale konform dispozitave të përgjithshme<sup>106</sup>, ai ka të drejtë në mbrojtje invalidore nga sëmundjet që i ka marrë gjatë kryerjes së detyrave në punë. Mbrojtja shëndetësore është garantuar me aktet ligjore dhe nënligjore.

Personat e dënuar me burg gjatë vuajtjes së dënimit kanë të drejtë në mbrojtje shëndetësore në ndihmë mjekësore si dhe kontroll specialistik. Kështu, sipas Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe akteve nënligjore të sferës penitensiare sferën e mbrojtjes shëndetësore e rregullojnë disa nene edhe atë nga: nenet 124- 134. Duhet përmendur se në realizimin e të drejtës në mbrojtje shëndetësore të personave të dënuar në institutet penitensiare të Republikës së Maqedonisë paraqiten disa vështirësi të caktuara. Në disa institucione penitensiare mungojnë personeli shëndetësor edhe atë: në (Tetovë, Gjevgjeli, Strumicë, Strugë, Prilep, Kumanovë, Pallankë, Veles, Ohër), ndërsa, në institucionet tjera është prezent ekipi i personelit shëndetësor me: mjek të praktikës së përgjithshme, stomatolog, mjek specialist, personel shëndetësor, mungesa e lokaleve për shërim, mungesa e pajisjeve të nevojshme dhe aparaturave etj.<sup>107</sup>

Sipas dispozitave të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale neni 133 personat e dënuar me burg gjatë vuajtjes së dënimit kanë të drejtë në arsimim dhe në ngritje profesionale të tyre.

Kjo e drejtë themelore e të dënuarve realizohet në pajtim me kushtet ekzistuese të çdo instituti penitensiar. Në pajtim me neni 135 të ligjit në fuqi “Arsimimi në institucionet penitensiare është obligativ, si pjesë e sistemit të përgjithshëm arsimor. Arsimimi i personave të dënuar organizohet në vetë institucionin ose në selinë e tyre”. Në pajtim me aktet penitensiare në fuqi personat e dënuar

---

<sup>104</sup> I. Saliu. “E Drejta Penale”, Prishtinë, 2005,

<sup>105</sup> V. Kambovski. Kazneno pravo, Opsht del. Skopje, 2004.

<sup>106</sup> Franjo Bačić: Krivično pravo, opći dio, Informator, Zagreb 1995,

<sup>107</sup> Shih; Rendi shtëpiak. i institucionit të Idrizovës. Nen 22. f. 10. janar. 2008.



pas mbarimit të shkollimit pajisen me dëshmi, diploma, certifikata, dhe dëftesa.<sup>108</sup> Sipas dispozitave në Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale neni 144 personat e dënuar kanë të drejtë të pranojnë vizita nga anëtarët më të ngushtë të familjes, por me lejen e drejtorit të institucionit mundë të vizitohen edhe nga personat tjerë, nga ora 8,00 deri më 14,00.

Në institucionin e Idrizovës për shkak numrit të stërngarkuar me persona të dënuar vizitat realizohen për qytetarët e Shkupit ditëve të shtuna, ndërsa ditëve të diela për personat me vendbanim jashtë qytetit të Shkupit, vizitat zgjatin deri 60 minuta dhe realizohet në prezencën e personit zyrtar<sup>109</sup> Personat e dënuar në entet ndëshkuese- përmirësuese kanë të drejtë në pranimin e paketave nga familjet e tyre të cilat përmbajnë ushqime dhe gjësende të tjera për nevojat personale. Po ashtu kanë të drejtë edhe në pranimin e mjeteve monetare për plotësimin e nevojave të tyre. Lloji dhe sasia e ushqimeve që vijnë nga jashtë duhet të jenë mirë të paketuara, ato kontrollohen para se t'i jepen të dënuarit nga administrata e entit ndëshkues, meqë mund të ketë keqpërdorim të tyre ose mundësi të përhapjes së ndonjë infektimi (neni 151 al.3 – LZSP).Pra, të dënuarit përveç paketave, në entet ndëshkuese kanë të drejtë edhe në pranimin e mjeteve monetare që marrin prej familjeve të tyre, por ato duhet të depozitohen financën e entit ndëshkues dhe mund t'u jepen atyre sipas nevojës dhe kërkesës së tyre( neni 149 al. 4 LZSP).

Sipas Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të Republikës së Maqedonisë neni 142 personat e dënuar në entet ndëshkuese kanë të drejtë në korrespondencë me botën e jashtme me anëtarët e familjeve të tyre dhe personat e tjerë si dhe në informim. Të dënuarit kanë të drejtë në letërkëmbim përmes letrave dhe telegrameve, telefonit etj. Përmbajtja e letrave dhe telegrameve nuk kontrollohet, zakonisht ato hapen dhe mbyllen në prani të nëpunësit kompetent edukatorit të institucionit( neni 143- LZSP).Personat e dënuar në institucionet penitensiare kanë të drejtën e informimit. Pra, ato kanë të drejte informohen për rregullat disiplinën e institucionit, si dhe për çdo akt tjetër që u jepet atyre që të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë vuajtjes së dënimit. Gjithashtu, atyre u jepet e drejta e leximit të literaturës, shtypit, si dhe ndjekja e mediave të komunikimit masiv.<sup>110</sup>

Legjislacioni pozitiv në Republikën e Maqedonisë u jep të drejtë personave të dënuar në institucionet penitensiare të paraqesin kërkesa dhe ankesa lidhur me zbatimin e ligjit, akteve

---

<sup>108</sup> Shih; Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve nenet 113- 122.

<sup>109</sup> Shih; Rregullore për llojin , kushtet e kryerjes së punëve me dobi të përgjithshme. Nr. 08-1148/1. Shtator. 2008. Shkup.

<sup>110</sup> Shih. Raporti i Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale 2009, Shkup

nënligjoredhe rregullave të brendshme (neni 174 – LZSP[15]. Po ashtu ata mund të bëjnë ankesa ndaj veprimeve dhe sjelljeve arbitrare dhe jo humane të personelit penitenciar dhe shërbimeve të caktuara në institucionet, duke shprehur në këtë mënyrë vërejtjet dhe pakënaqësitë e tyre lidhur me këto sjellje dhe qëndrime. Respektivisht, të dënuari, me ankesë mund t'i drejtohen: drejtorit të institucionit, inspektorëve të drejtorisë, drejtorit të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, ministrit të Drejtësisë, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, organizatave jo qeveritare, avokatit të popullit, komisionit për të drejtat e njeriut dhe gjyqit evropian për të drejtët e njeriut të këshillit të Evropës sipas (nenit 174 – LZSP). Kësisoj, organet kompetente duhet t'i shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se një muaj nga paraqitja e tyre.

Mund të konstatoj se e drejta në kërkesa dhe ankesa në sistemin penitenciar të Republikës së Maqedonisë konsiderohet një ndër të drejtat mjaft të rëndësishme, e cila u takon personave të dënuar. Mirëpo, duhet theksuar se zbatimi praktik dhe realizimi i tyre has në disa pengesa dhe vështirësi të caktuara, gjë që e dëshmojmë mjaft mirë edhe opinionet e marra nga vetë personat e dënuar.

### **3.3.1 E drejta për ankesa dhe ndihmë juridike**

Personat e dënuar gjatë qëndrimit në institucion kanë të drejtë në shfrytëzimin e ndihmës profesionale juridike, këshillave juridike, që njëherit është edhe obligim i shërbimit juridik nëpër institucionet, në vazhdim do të japim disa të dhëna të shërbimeve që i shfrytëzojnë personat e dënuar në institucionin e Idrizovës edhe atë.<sup>111</sup>

### **3.3.2 E drejta e këmbimit të letrave**

Nga trajtimi i deri tashëm, mund të konstatojmë se në sistemin penitenciar të Republikës së Maqedonisë janë paraparë mjaft të drejta të të dënuarve dhe në këtë janë përfshirë disa kërkesa moderne penitenciare. Mirëpo, realizimi i disa prej tyre në praktikën penitenciare nuk është përherë i zbatueshëm dhe se, edhe në këtë rrafsh paraqiten pengesa dhe vështirësi të caktuara, gjë që pengon dhe vështirëson edhe vetë procesin e risocializimit dhe riedukimit të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.<sup>112</sup>Në institucionet penitenciare, kemi konstatuar se personave të dënuar t'u

---

<sup>111</sup> Shih: Raporti vjetor i Institutit ndëshkues të Idrizovës, 2006, f. 42, 2007, f. 43.

<sup>112</sup> Po aty.

jepen leje të veçanta në rastet e caktuara me dispozitat juridike penitensiare. Po ashtu mund të fitojnë edhe leje shpërblyese, shpërblime, ulje dënimi dhe beneficione të tjera për arsye të sjelljeve të mira, të angazhimit në punë dhe rezultateve të arritura në aktivitete të ndryshme. Një praktikë e tillë është mjaft e rëndësishme, në riedukimin dhe risocializimin e personave të dënuar. Duke u nisur nga rëndësia tyre gjykojmë se ato duhet të begatohen me anë të rregullimit normativ edhe të disa beneficioneve, por të cilat nuk janë precizuar me dispozitat përkatëse penitensiare. **Në burgun e Idrizovës ekziston mundësia e këmbimi të letrave.**

### 3.3.3 E drejta për pranimin e pakove

Të burgosurit po refuzojnë të punojnë duke kërkuar që të ndryshohet Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili ua ka shkurtuar pushimin në familje brenda vitit dhe ua ndalon pranimin e pakove ushqimore nga familjarët.<sup>113</sup> Sipas rregullores së përgjithshme të burgut të Idrizovës, garantohej respektimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të të paraburgosurve dhe të dënuarve, rehabilitimin, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e funksionimit të regjimit të brendshëm, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer, rehabilitimin dhe ri-integrimin, organizimin e shërbimit shëndetësor, si dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi. **Ushqimi**<sup>114</sup>

1. Të paraburgosurve apo të dënuarve u sigurohet ushqim për tri vaktet, sipas normave dhe llojshmërisë, të përcaktuara me akte nënligjore.
2. Të paraburgosurit apo të dënuarit i lejohet furnizimi nga familja dhe njësia e tregtimit në institucion 4 herë në muaj me produkte ushqimore, ku në çdo radhë mund të pranohen deri në 5 kg ushqime, 3 kg fruta, ndërsa lëngjet duhet të jenë me ambalazh të tejdukshëm dhe të hapura. Cigaret nuk llogariten në peshën e ushqimeve.
3. Institucioni u siguron të paraburgosurve apo të dënuarve të sëmurë dietë të veçantë, sipas rekomandimeve të mjekut.

<sup>113</sup> Abetarja e të burgosurve, të drejta dhe detyrime, Botuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të drejtat e njeriut, [http://www.ministryofjustice.gr/site/Portals/0/uploaded\\_files/uploaded\\_24/496\\_16email.pdf](http://www.ministryofjustice.gr/site/Portals/0/uploaded_files/uploaded_24/496_16email.pdf)

<sup>114</sup> Rregullore e përgjithshme e burgjeve,

### 3.3.4 E drejta për vizita dhe kontrollime mjekësore

Mbrojtja shëndetësore është garantuar me aktet ligjore dhe nënligjore. Personat e dënuar me burg gjatë vuajtjes së dënimit kanë të drejtë në mbrojtje shëndetësore në ndihmë mjekësore si dhe kontroll specialistik<sup>115</sup>. Kështu, sipas Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale dhe akteve nënligjore të sferës penitensiare sferën e mbrojtjes shëndetësore e rregullojnë disa nene edhe ato nga: nenet 124- 134. Duhet përmendur se në realizimin e të drejtës në mbrojtje shëndetësore të personave të dënuar në institutet penitensiare të Republikës së Maqedonisë paraqiten disa vështirësi të caktuara.

Në disa institucione penitensiare mungojnë personeli shëndetësor edhe atë: në (Tetovë, Gjevgjeli, Strumicë, Strugë, Prilep, Kumanovë, Pallankë, Veles, Ohër), ndërsa, në institucionet tjera është prezent ekipimi i personelit shëndetësor me: mjek të praktikës së përgjithshme, stomatolog, mjek specialist, personel shëndetësor, mungesa e lokaleve për shërim, mungesa e pajisjeve të nevojshme dhe aparaturave etj.<sup>116</sup> Shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat në heqje lirie janë një çështje me rëndësi direkte për mandatin e KPT.1 Një nivel i papërshtatshëm i kujdesit shëndetësor mund të çojë shpejt në situata që bien në fushëpamjen e termit "trajtim poshtëruar dhe çnjerëzor". Më tej, shërbimi i kujdesit shëndetësor në një institucion të caktuar mundet potencialisht të luajë një rol të rëndësishëm në luftimin e shkakut të keqtrajtimit, si në atë institucion edhe tjetërkund (veçanërisht në stacionet e policisë).

Për më tepër, ai ka mundësinë të ketë ndikim pozitiv mbi cilësinë e përgjithshme të jetës në institucionin ku funksionon.<sup>117</sup> Kur hyjnë në burg, të gjithë të burgosurit duhet të shihen pa vonesë nga një anëtar i shërbimit të kujdesit shëndetësor të institucionit. Në raportet e tij deri tani KPT ka rekomanduar që çdo i burgosur që arrin rishtas në burg duhet të pyetet siç duhet dhe në se është e nevojshme të ekzaminohet fizikisht nga një mjek sa më parë që të jetë e mundur pas pranimit. Duhet shtuar se në disa vende, kontrolli mjekësor në pranim kryhet nga një infermier plotësisht i kualifikuar, që i raporton mjekut. Kjo metodë e fundit mund të konsiderohet si një përdorim më efektiv i burimeve në dispozicion.<sup>118</sup>

---

<sup>115</sup> Shih: Rendi shtëpiak. Idrizovë, Ibid. neni 37.

<sup>116</sup> Raporti vjetori i Drejtorisë. Janar. 2008. Shkup.

<sup>117</sup> Po aty.

<sup>118</sup> Kjo kërkesë është riformuluar me vonë si vijon: çdo i burgosur i porsa.ardhur duhet të pyetet dhe ekzaminohet fizikisht siç duhet nga një mjek sa më parë të jetë e mundur pas arritjes; përveç rrethanave të jashtëzakonshme,

### 3.3.5 E drejta për korrespondenca me avokatin

Kur flasim për rolin e avokatit në shoqëri, kemi parasysh se ai si profesion zë fill qysh nga lashtësia, fillimisht në Athinë dhe më pas në Romën e Lashtë. Në Athinë avokatë konsideroheshin oratorët (orators), të cilët mund t'i jepnin këshilla ligjore një miku të tyre pa pasur të drejtë që t'i kërkonin atij paraprakisht apo në fund të punës një shpërblim në të holla, ashtu siç veprohet sot në profesionin e lirë të avokatit. Ndërsa në Romën e Lashtë, rreth vitit 204 Përpara Krishtit, ashtu si dhe në Athinë, avokatë quheshin ata të cilët ishin trajnuar në retorikë (rhetoric). Oratorët mund të jepnin edhe këshilla ligjore. Me kalimin e kohës prej tyre lindën edhe të ashtuquajturit “këshilltarë ligjorë” (iuris consulti), të cilët e ushtronin profesionin jo si një mënyrë jetese, por si një hobi. Në Romën Perandorake profesioni i avokatit filloi të merrte zhvillim të madh, duke hyrë si një pjesë e rëndësishme e jetës tregtare (qarkullimit juridik) që zhvillohej në këtë periudhë. Me zhvillimin e marrëdhënieve tregtare njohu zhvillim edhe profesioni i avokatit. Në Perandorinë Bizantine profesionin e avokatit e gjejmë jo vetëm më të zhvilluar, por edhe më të organizuar. Duke cituar juristin e njohur Fritz Schulz<sup>119</sup> konstatojmë se, në shekullin e katërt gjërat kishin ndryshuar në Perandorinë lindore ku “avokatët tani ishin me të vërtetë profesionistë”.<sup>119</sup> Burgjet në Maqedoni, për dallim nga vitet e mëhershme, gjatë këtij viti kanë pasur numër më të vogël të të burgosurve. Sipas të dhënave dhe analizave të zyrës së Avokatit të Popullit, miratimi i Ligjit për amnisti i cili u miratua në janarin e 2018-ës i ka dhënë rezultat e veta. Ombudsmani i Maqedonisë, përmes Mekanizmit Parandalues Nacional dhe vizitave që i kanë realizuar në më shumë institucione ndëshkuese përmirësuese në vend, ka konstatuar se amnistia e fillimvitit kishte ndikuar në reduktimin e mbipopullimit në burgjet e vendit, shkruan gazeta KOHA. Megjithatë, qëndrim i Avokatit të Popullit është se kjo amnisti ishte një masë me efekt të njëfishtë dhe e njëjta nuk do ta zgjidhte përgjithmonë problemin e mbipopullimit të burgjeve. “Kur bëhet fjalë për popullatën e burgjeve, duhet të merret parasysh se ajo është popullatë e lëvizshme – disa shkojnë, por vijnë persona të tjerë të cilët do të vuajnë dënime me burg, kështu që nuk duhet të mbështetemi vetëm në këtë masë. Kjo do të thotë se duhet të përshpejtohet procesi dhe zgjerimi i kapaciteteve të burgjeve, në mënyrë që të mos gjendemi përsëri në situatë që të burgosurin ta vuajnë dënimin me burg në

---

pyetja/ekzaminimi duhet të kryhen në ditën e arritjes, veçanërisht në institucionet e ndalimit para gjykimit. Ky kontroll mjekësor mund të kryhet edhe nga një infermier/e plotësisht i/e kualifikuar që i raporton një mjeku.

<sup>119</sup> Fritz Schulz (16 Qershor 1879 – 12 Nëntor 1957), jurist gjerman dhe një historian i së drejtës, një prej doktrinarëve më të rëndësishëm në të drejtën civile (Roman Laë) në shekullin e 20-të. Emigroi në Angli për shkak të origjinës së tij hebraike dhe të përndjekjes nga nazistët gjermanë.

kushte skajshëm johumane. Në të vërtetë, Avokati i Popullit vite me radhë, konstatonte gjendje të mbipopullimit dhe kushte të paimagjinueshme në burgje”, thonë nga Ombudsmani.

### **3.4 Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit me burgim të përjetshëm**

Parashkrimi<sup>120</sup> është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një vepre penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit). Si çdo legjislacion penal tjetër, edhe legjislacioni penal i Maqedonise ka kushtuar vëmendje këtij instituti.

Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një vepre penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit). **Ekzekutimi i aktgjyqimit penal të huaj** kuptojmë rastet kur një personi i është dhënë dënimi në shtetin ku e ka kryer veprën penale dhe ai më pas i dorëzohet shtetit tjetër, zakonisht shtetit shtetësinë e të cilit e ka apo ku e ka vendbanimin e përhershëm me qëllim që atje ta mbaj dënimin.<sup>121</sup>

Çështja e ekzekutimit të aktgjyqimit penal të huaj, është rregulluar me normat kushtetuese dhe ligjore të shteteve. Me anë të këtyre normave interne, në procedurë paraprake kërkohet që të konstatohet nëse janë plotësuar kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjyqimit të huaj penal.

---

<sup>120</sup> Ismet Saliu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq.566

<sup>121</sup> Rendi shtëpiak i Institucionit të Idrizovës, Shkup, janar 2008, neni 46, f.18.

## KAPITULLI I KATËRT

### 4.1.Struktura e personave të dënuar

### 4.2.Mosha e personave të dënuar

### 4.3.Gjinia e personave të dënuar

### 4.4.Numri I personave të dënuar sipas llojit të veprave penale

Karakteristikë e përbashkët e të gjithë përpjekjeve për ndarje dhe klasifikim të veprave penale apo personave të dënuar, është angazhimi që në pikëpamje shkencore të bëhet individualizimi I dënimit dhe individualizimi i tretmanit me qëllim të përmirimit të tyre.<sup>122</sup>

Sistemi i vuajtjes së burgimit është i rregulluar në bazë të parimeve të **vuajtjes grupore të dënimit** (n.18, LES). Dërgimi i personit të dënuar shkon në vuajtje të dënimit në bazë të vendimit të dhënë nga gjykata themelore kompetente. Për shkak të realizimit të qëllimeve të trajtimit individual, personat e dënuar me observacionin e tyre klasifikohen në ente dhe në grupe.<sup>123</sup> **Klasifikimi** në institucione të ndryshme të llojit të hapur ose të mbyllur (të a.q klasifikim horizontal ekstern) bëhet sipas gjinisë, moshës, kohëzgjatjes së dënimit dhe nevojës për masa më të rrepta për pengim nga ikja.

Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këteleja (Quetele) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca më e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intensitetin e forcës fizike dhe pasionin e personit<sup>124</sup>.

Pas mbulimit të bazave teorike të dënimit me burg në kapitujt e mëparshëm, kapitulli vijues i hulumtimit do të analizojë aplikimin e dënimit me burg në Republikën e Maqedonisë në periudhën 2013-2017. Kjo analizë do të bazohet në statistikat e Zyrës Shtetërore të Statistikave. Përpunimi i të dhënave statistikore do të bëjë të mundur që të të mblidhen dhe shfaqen përmes tabelave dhe grafikëve.

<sup>122</sup> R.Halili, Penologjia, Prishtinë, 2010,fq.156

<sup>123</sup> V.Kambovski&I.Zejneli, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Tetovë,2018,fq.277

<sup>124</sup> V. Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, faqe 123;

Viti	Numri i personave të gjykuar me burg të përjetshëm	Numri i përgjithshëm i personave të cilëve është caktuar dënimi burg i përjetshëm	Numri i përgjithshëm i personave të dënuar që ata kanë theksuar dënimin me burg të përjetshëm	Numri i përgjithshëm i të dënuarve me masa alternative
2013	1200	800	400	250
2014	1000	400	450	50
2015	450	50	400	400
2016	750	350	400	500
2017	1200	200	800	150

**Tabela nr.1 Situata e dënimit me burgim të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2013-2017<sup>125</sup>**

Sipas kësaj mund të kuptojmë dinamikën e ekzekutimit me burg të përjetshëm në Republikën e Maqedonisë. Sipas kësaj tabele mund të kuptojmë se periudhën e fundit nga 2013-2017 ka pasur të dënuar me dënim të përjetshëm.

**Tabela nr.2 Situata e dënimeve në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga viti 2013-**

Viti	Numri i personave të gjykuar	Numri i përgjithshëm i personave të cilëve u është caktuar dënimi	Numri i përgjithshëm i personat e dënuar që ata kanë i theksuar dënimin me burg	Numri i përgjithshëm i të dënuarve me masa alternative
2013	9539	5624	3064	3914
2014	11683	6263	3507	5417
2015	10312	5848	3524	4644
2016	8172	3834	1922	4332
2017	6273	2739	1255	3534 <sup>126</sup>

**2017<sup>127</sup>**

Për të kuptuar dinamikën, strukturën dhe marrëdhëniet e këtij fenomeni, pra mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burg në Republikën e Maqedonisë. Nga Tabela 2 mund të shihet se numri i të rriturve

<sup>125</sup> Burimi: Државен завод за статистика, viti 2014, SHKUP

<sup>126</sup> Burimi: Државен завод за статистика viti 2015, SHKUP

<sup>127</sup> Burimi: Државен завод за статистика, viti 2016, SHKUP



të dënuar që janë dënuar me sanksione penale është më i larti në vitin 2014 82 dhe është 11 683 të dënuar. Ky numër në vitin 2013 ishte 9539 personat e dënuar. Nga 2015 deri sot ka një trend të uljes së numrit të personave të dënuar, kështu që atë vit numri i personave të dënuar ishte 10312.

Viti vijues 8172 të jetë 6273. Në vitin 2017, numri i përgjithshëm i dënimeve për të rritur i dënuar Situata është si vijon: Në vitin 2013, numri i të dënuarve për të rritur të dënuar të dënuar me 5624 u rrit në 6263 vitin e ardhshëm. Nga viti 2014 e deri më sot mund të shohim një trend në rënie në numrin e përgjithshëm të të rriturve të dënuar që janë dënuar. Kështu që në vitin 2015 numri i të rriturve të dënuar që u dënuan ishte 5848, në vitin 2016 ky numër ishte 3834 deri në 2739 në 2017. Dhe Zyra e Statistikave Shtetërore doli me kërkesën e mëposhtme për zvogëlimin e numrit të autorëve. të krimeve për vitin 2017: Ulja e numri i të rriturve të raportuar, autorë të njohur të krimeve, me 10.6 përqind në 2017 në krahasim me 2016. Sipas SSO, në vitin 2017, në krahasim me 2016, numri i të rriturve të dënuar është ulur me 23.2 përqind , dhe numri i të pandehurve u ul me 20.4 përqind. Situata është e ngjashme për fëmijët në kundërshtim me ligjin. Numri i fëmijëve të raportuar në konflikt me shkelësit e ligjit shkalla e krimit në 2017 u ul me 1.5 përqind në krahasim me vitin 2016. Në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016, numri i fëmijëve të dënuar në konflikt me shkelësit e ligjit u ul me 21.4 përqind. 144 Kur bëhet fjalë për marrëdhëniet midis numrit të fjalive dhe numrit të Masat alternative të vendosura, dënimet janë më të theksuara sesa masat alternative. Kështu, në vitin 2013 raporti ishte 5624 për dënime të dënuara kundër 3914 masave alternative të dënuara, në vitin 2014 - 6263 me 5417 dënuar me masa alternative ndërsa u vendosën masa alternative për 4464 persona. Në vitin 2016, numri i masave alternative të shqiptuara është më i lartë se numri i dënimeve të dënuara, duke arritur në 4332, ndërsa numri i dënimeve është 3834. Në vitin 2017, numri i masave alternative të dënuara ishte 3534 ndërsa numri i dënimeve ishte 2739. Nga të dhënat e mëposhtme, ne mund të shohim se dënimi i masave alternative në lidhje me dënimet në dy vitet e fundit ka qenë në rritje të vazhdueshme. numri i të rriturve të dënuar në përgjithësi, si dhe numri i përgjithshëm i të rriturve të dënuar të dënuar me burg për periudhën 2013-2017.

Viti	Dënimet						
	Gjithësej	Burg të përjetshëm	Dënim kryesor – para	Gjobë	Ndalesa mbi ushtrimin e detyrës	Ndalesë mbi ngasjen e automjetit	Ekstradimin e një të huaji nga
2013	5624	1200	49	/	95	17	21
2014	6263	1000	83	9	97	25	22
2015	5848	450	88	3	104	40	14
2016	3834	750	64	1	72	35	10
2017	2739	1200	8	1	65	16	/
							128

**Tabela nr.3 Situata e dënimeve në Republikën e Maqedonisë në periudhën 2013 -2017**

Nga tabela nr.3 mund të shohim dënimin me burg më të zakonshëm për të gjitha llojet e dënimeve nga 2013 deri në 2017. Në periudhën nga 2013 deri në 2017, burgimi është dënimi më i zakonshëm nga sistemi i sanksioneve që ekziston në vendin tonë.

#### 4.1 Struktura e personave të dënuar

Viti	Struktura e personave të dënuar me burg të përjetshëm
2013	1200
2014	1000
2015	450
2016	750
2017	1200

**Tabela nr.4 Struktura e personave të dënuar me burgim të përjetshëm**

Sipas kësaj tabele mund të shohim se kemi një variancë të numri të dënimit të përjetshëm. Ekzekutimi i dënimit me burgim në Maqedoni ka rrugën e vet të zhvillimit dhe transformimit.

<sup>128</sup> Burimi : Државен завод за статистика

Mjetet dhe metodat e ekzekutimit të këtij dënimi dhe mënyra e trajtimit të personave të dënuar gjatë qëndrimit në institucione korrektuese, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar e deri në ditët e sotme, ishin në varësi nga rrethanat e caktuara historike, shoqërore, ekonomike, politike, ideore, kulturore etj., si dhe nga vetë qëllimi i këtij dënimi.

#### 4.2 Moshë e personave të dënuar

Grup moshë e të dënuarve me burg të përjetshëm për periudhën 2013-2017	Numri i të burgosurve
Nga 27 - 30 vjeç	1000
Nga 31 – 40 vjeç	1200
Nga 41 – 50 vjeç	250
Mbi 50	2150

**Tabela nr.5 Moshë e personave të dënuar me burgim të përjetshëm**

Sipas kësaj tabele mund të kuptojmë 4500 numri i përgjithshëm i të dënuarve. Në grupmoshën 27-30 vj kemi 1000 të dënuar, në grupmoshën 31-40 vj kemi 1200 në grupmoshën 41-50 vj kemi 250 në grupmoshën mbi 50 kemi 2150 persona të dënuar me burg të përjetshëm.

Për periudhën 2015, 2016, 2017 kemi hetuar 43 rastë të burgimit me burg të përjetshëm në Burgun e Idrizovës sipas raportit të fundit që kemi marrë në këtë burg për shkakë të studimit.

Grup moshë e të anketuarëve	Numri i pjesëmarrësve
Nga 20 – 25 vjeç	20
Nga 25 - 30 vjeç	5
Nga 31 – 40 vjeç	5

Nga 41 – 50 vjeç	10
Nga 50 – 55 vjeç	3

#### 4.3 Gjinia e personave të dënuar

Viti	Meshkuj	Femra
2013	1000	200
2014	788	212
2015	300	150
2016	750	0
2017	1119	1

**Tabela nr.6 Gjinia e personave të dënuar**

Sipas kësaj tabele mund të konkludojmë se gjinia mashkullore dominon në burgje, edhe gjinia femërore deri diku është e dënuar. Në vitin 2013 kemi 1000 nga gjinia mashkullore dhe 200 nga gjinia femërore, në vitin 2014 kemi 788 nga gjinia mashkullore dhe 212 persona të dënuar me burg të përjetshëm, në vitin 2015 kemi 300 të dënuar nga gjinia mashkullore kurse 150 kemi të dënuar me burg të përjetshëm të gjinisë femërore, në vitin 2016 kemi 750 të dënuar të gjithë të gjinisë mashkullore, kurse për 1 person të gjinisë femërore ne vitin 2017 prishet bilanci i 1200 të dënuarve të gjinisë mashkullore në vitin 2017.

<b>Numri i përgjithshëm i të dënuarve me burg</b>	<b>43</b>
Meshkuj	42
Femra	1

## Gjinia e personave të dënuar në Burgun e Idrizovës 2015-2017

### 4.4.Numri i personave të dënuar sipas llojit të veprave penale

	Dënimi me burg të përjetshëm për vrasje të rënda	Dënimi me burgim përjetshme i përdhuni	Dënimi me burgim të përjetshëm për marrëdhënie gjinore me të mitura	Dënime me burgim të përjetshëm për kindapime të rënda	Dënime me burgim të përjetshëm për gjenocid	Dënimet me burgim të përjetshëm për drogë dhe trafikim me njerëzit
<b>2013</b>	500	200	100	200	150	50
<b>2014</b>	200	150	150	100	200	200
<b>2015</b>	120	80	50	50	0	150
<b>2016</b>	144	28	45	22	2	509
<b>2017</b>	800	100	45	45	10	200

### Tabela nr.7 Numri i personave të dënuar me burg të përjetshëm sipas llojit të veprave penale

Sipas kësaj tabele shohim se dënimet me burg të përjetshëm janë klasifikuar sipas llojit të veprave penale. Veprat penale të dënuara me burg të përjetshëm janë vrasjet e rënda, përdhunimet, kryerja e marrëdhënive gjinore me të mitura, kidnapime të rënda, gjenocide dmth krime lufte dhe droga së bashku me trafikimin e njerëzve. Qëllimi kryesor i publikimit është të paraqes një pasqyrë të hollësishme të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë në të njëjtin publikim statistika për katër fazat, polici, prokurori, gjykatë dhe burgje.

Publikimi është përqëndruar jo vetëm te statistikat por edhe te grumbullimi i të dhënave, mënyra se si mbledhen dhe analizohen të dhënat . Është e rëndësishme të theksohet se të dhënat e paraqitura në këtë publikim janë përpiluar nga burime të ndryshme të të dhënave. Të dhënat mbi veprat penale dhe të drejtësisë penale ndryshojnë në të njëjtin juridiksion, nga njëra fazë në tjetrën. Statistikat e paraqitura në kapitujt e ndryshëm janë të vështira për t'u bashkëanalizuar pasi secili institucion mbledh dhe përpunon statistika në bazë të nevojave të veta, ndryshon mënyra e numërimit, si dhe të

dhënat mund të kenë rrjedhur nga periudha të ndryshme kohore. - Numri i personave të dyshuar të regjistruar gjatë një viti nuk mund të krahasohet me numrin e të pandehurve të regjistruar për të njëjtin vit pasi disa nga të pandehurit mund të jenë paraqitur si persona të dyshuar në vitin e kaluar. - Numri i të pandehurve të regjistruar gjatë një viti nuk mund të krahasohet me numrin e personave të dënuar në të njëjtin vit pasi të dënuarit mund të kenë qenë të pandehur në një periudhë të ndryshme kohore, psh një vit më parë. Pra, është shumë e rëndësishme që statistikat të shihen në një perspektivë më të gjerë dhe më të përgjithshme, për shembull në krahasimin e periudhave kohore, në vend që të krahasohen numrat specifik përkundrejt njëri-tjetrit.

Vite	Gjobë	Deri 2vj	2-5vj	5-10vj	10-25vj	25-35	Burgim të përjetshëm në Burgun e idrizovës	Të dënuar
<b>2012</b>	3508	11.132	918	407	166	4	<b>6</b>	16.141
<b>2011</b>	3032	10096	994	341	134	7	<b>10</b>	10
<b>2010</b>	1881	7491	1114	324	79	6	<b>8</b>	8

#### **Numri gjithsej i personave të dënuar sipas masave të dënimit, për periudhën 2010-2012**

Në vitin 2012 prej 6 të dënuarve 1 është grua kurse në vitet radhazi 2016,2017 të gjithë janë të gjinisë mashkullore..

Vite	Gjobë	Deri 2vj	2-5vj	5-10vj	10-25vj	25-35	Burgim të përjetshëm në Burgun e idrizovës	Të dënuar
<b>2012</b>	487	1557	118	69	109	4	<b>6</b>	2350

<b>2011</b>	422	1636	122	74	84	6	<b>4</b>	2348
<b>2010</b>	252	1227	114	50	41	6	<b>5</b>	1695

**Numri i personave të dënuar sipas masave të dënimit për vepra penale kundër personit, për periudhën 2010-2012**

Përqindja e personave të dënuar sipas masave të dënimit në totalin e personave të dënuar është paraqitur në figurën mëposhtë. Gjatë periudhës 2010-2012 personat e dënuar deri në 2 vjet zënë përqindjen më të madhe, ndjekur nga persona të dënuar me gjobë. Në vitin 2010, nga 1.695 personave të dënuar, 72,4 % prej tyre u dënuan me burg deri në 2 vjet, 14,9 % u dënuan me gjobë, 6,7 % u dënuan me 2-5 vjet burg, 2,9 % prej tyre 5-10 vjet burg dhe 3,1 % u dënuan me më shumë se 10 vjet burg. Struktura dominon gjinia Mashkullore.

Vite	Gjobë	Deri 2vj	2-5vj	5-10vj	10-25vj	25-35	Burgim të përgjeshëm në Burgun e idrizovës	<b>Ë të dënuar</b>
<b>2012</b>	1390	4388	543	265	25	0	<b>0</b>	6612
<b>2011</b>	1574	4314	699	225	35	0	<b>3</b>	6850
<b>2010</b>	973	3436	779	214	23	0	<b>1</b>	5426

**Numri i personave të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale sipas masave të dënimit, për periudhën 2010-2012**

Në vitin 2010, nga 5.426 të dënuar për kategorinë vepra të tjera penale, 63,3 % e tyre u dënuan me burgim deri në 2 vjet, 17,9 % u dënuan me gjobë, 14,4 % u dënuan me 2-5 vjet burgim, 3,9 % u dënuan me 5-10 vjet burgim dhe 0,4 % me më shumë se 10 vjet burgim.

## 4.5 Metodat e analizës së të dhënave

### ANKETA

Anketa është zhvilluar në qytetin e Shkupit pasi është një vend ku frekuentohet gjykata e apelit dhe burgu i Idrizovës, ku janë të përfshirë persona me shkollim të mesëm dhe të lartë të grupmoshave të ndryshme. Numri i personave të anketuar janë 60 persona. 30 të gjinisë femërore dhe 30 të gjinisë mashkullore. Në anketë janë parashtruar gjithësej 15 pyetje me mundësi të ndryshme për tu përgjigjur, në mënyrë të anketuarit të kenë sa më lehtë hapsirën për përgjigje dhe të mund të shprehin mendimin e tij të lirë.

Ideja e kësaj ankete do të jetë analizimi i mendimeve për burgun e Idrizovës. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të analizohet impakti i markave vendore të konsumatorët në

<b>Anketa përmban këto të dhëna</b>	<b>Numri i përgjithshëm i të anketuarve 60 vetë</b>
<b>Gjinia</b>	30 femra dhe 30 meshkuj
<b>Grupmosha</b>	Nga 25 deri 55 vjet
<b>Niveli i arsimit</b>	Të mesëm dhe të lartë

përgjithësi. MOSTRA e cila është marrë për hulumtim është e përbër nga 60 të anketuar, të gjinisë femrore dhe mashkullore. Hulumtimi është kryer me metodën e anketimit ku kam përdorur pyetësorin si instrument për mbledhje të të dhënave primare.


### Rezultatet e hulumtimit janë këto të paraqitur në tabela dhe grafikone.

Numri i përgjithshëm është i të anketuarve është 60 persona, prej të cilave 30 janë meshkuj ndërsa 30 janë femra.

<b>Numri i përgjithshëm i të anketuarve</b>	<b>60</b>
<b>Meshkuj</b>	37
<b>Femra</b>	23



**Tabela 1. Numri i të anketuarve reth burgimit të përgjithshëm si fenomen në Republikën e Maqedonisë.**




**Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm i të anketuarve**

Gjithësej 60 të anketuar, meshkuj 62 %, femra 38%.

Në tabelën e dytë kemi paraqitur kategorinë në grupmosha të pjesëmarësve në anketë.

Grup mosha e të anketuarve	Numri i pjesëmarësve
Nga 20 – 25 vjeç	17
Nga 25 - 30 vjeç	3
Nga 31 – 40 vjeç	10
Nga 41 – 50 vjeç	12
Nga 50 – 55 vjeç	18

**Tabela 2. Grup moshë e të anketuarve**



**Grafikoni 2. Grup moshë e të anketuarve**

Në grafikoni e dytë shihet qartë në përqindje moshë e pjesëmarrësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhe është nga moshë 50-55 vjeç, nga kjo kuptojmë se pjesëmarrësit e kësaj moshë janë më të informuar sa i përket veprave penale dhe burgut të përjetshëm në RM.

Niveli i shkollimit	Kategoritë e të anketuarve
Me shkollim të mesëm	22
Me shkollim të lartë	38

**Tabela 3. Kategoritë e të anketuarve**

Tabela e tretë nivelin e shkollimit të të anketuarëve. Nga pjesëmarrësit në hulumtimin del se të anketuarit në numër më të madh ishin me shkollim të lartë ndërsa me përqindje më të vogël ishin me përqindje shkollim të mesëm.



**Grafikoni 3. Kategoritë e të anketuarve**

Nga grafikoni i tretë mund të kuptojmë se numri më i madh i të anketuarëve është me shkollim të lartë, pastaj janë niveli i dytë ata me shkollim të mesëm me përqindje pak më të vogël.

Vendbanimi i të anketuarve	Numri i të anketuarve në qytete përkatëse
<b>Shkup</b>	60

**Tabela 4. Vendbanimi i të anketuarve**

Në tabelën e katërt janë paraqitur vendbanimet e të anketuarve.



**Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarve**


Vendbanimi i të anketuarve është në Shkup.

Pyetjet e anketës janë gjithësej 5 në vazhdim do të paraqes çdo pyetje në përqindje me grafikon dhe përgjigjet e mara nga 2 mundësitë do të paraqes në tabelë.

A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
<b>Po</b>	43
<b>Jo</b>	17

**Tabela nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?**




**Grafikoni nr.5 A jeni të mendimit ju si qytetarë se duhet të këmbëngulni për të parandaluar vepra të rënda penale për të cilat është paraparë dënimi me burg të përjetshëm?**

72% anketuarve kanë deklaruar se po duhet të insistohet në këtë çështje kurse 28% kanë deklaruar se jo.

A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirim nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?

Mundësi për të përgjigjur	Numri i përgjigjeve
<b>Po</b>	42

**Tabela nr.6 A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?**



**Grafiku nr.6 A jeni të mendimit se dënimi i përjetshëm është dënimi i papërcaktuar i shqiptuar nga një gjykatë menjëherë pas dënimit për një vepër penale e cila kërkon që i burgosuri të mbahet në burg ose për pjesën e mbetur të jetës së tij fizike ose deri në lirimin nga një proces gjyqësor, kuazi-gjyqësor, ekzekutiv ose administrativ i cili vlerëson se i burgosuri më nuk paraqet rrezik për publikun e gjerë?**


Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se 70% e mbështesin këtë mendim kurse 30% nuk e mbështesin. Sipas këtij grafikoni kuptojmë se pyetja jonë është aprovuar. Shumica e vendeve që zbatojnë dënime të përjetshme kanë një periudhë minimale prej 20 deri në 30 vjet. Në juridiksionin e Mbretërisë së Bashkuar, periudha minimale për të vuajtur në burg përcaktohet në kohën e dënimit nga ana e trupit gjykues; ligji nuk parashikon një periudhë absolute minimale në këtë drejtim. Disa vende të tjera (p.sh. Bullgaria, Lituania, Malta, Holanda dhe, për krime të caktuara, Hungaria, Republika Sllovaqe dhe Turqia) nuk kanë një sistem të lirimit me kusht për të burgosurit e dënuar përjetësisht, prandaj dënimi me jetë mund të nënkuptojë fjalë për fjalë jetën (shih edhe paragrafin 73). Në anën tjetër, vlen të përmendet se një numër i shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nuk

kanë burgim të përjetshëm në librin e statutit.<sup>129</sup> Gjatë gjithë historisë, burgimi i përjetshëm ka qenë i lidhur pandashëm me dënimin me vdekje dhe progresivisht është bërë dënim alternativ për krimet më të rënda. Megjithatë, qëllimi fillestar i këtij zëvendësimi nuk ishte që të zbutej gjendja e personit të dënuar. Përkundrazi, pikëpamja mesjetare, e cila vazhdoi për shumë shekuj, ishte se burgimi me jetë në kombinim me punën e rëndë dhe izolimin me vetmi do të shihej nga shkelësit si një alternativë më e keqe se vdekja. Në të njëjtën mënyrë, njëri nga argumentet për mbajtjen e dënimit me vdekje ishte pikërisht se burgimi i përjetshëm me punë të rëndë ishte aq i vështirë se do të shkaktonte më shumë vuajtje për individin në fjalë dhe të ishte më mizor sesa dënimi kapital. Nga perspektiva e sotme, pikëpamja që personat që e vuajnë dënimin e përjetshëm (ose madje çdo dënim tjetër) duhet të marrin dënim shtesë nga ashpërsia e kushteve në burg është haptazi e papranueshme. Megjithatë, një këndvështrim i tillë ende është i ngulitur thellë në opinionin publik në shumë vende evropiane.

A e mbështetni edhe ju parimin ‘jeta është jetë’?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
<b>Po</b>	36
<b>Jo</b>	24

**Tabela nr.7 A e mbështetni edhe ju parimin ‘jeta është jetë’?**



<sup>129</sup> Për shembull, Andorra, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Portugalia, San Marino, Serbia, Sllovenia dhe Spanja. Më tej, në praktikë, dënimet me jetë nuk janë zbatuar, kurrë në Islandë a Lihtenshtajn.

### Grafikoni nr.7 A e mbështetni edhe ju parimin ‘jeta është jetë’?


60% e të anketuarve kanë deklaruar se 60% e mbështesin këtë parim kurse 40% nuk e mbështesin. Sipas mendimit tim siç u tha më lart, në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, një person mund të dënohet me burgim të përjetshëm pa mundësinë e liritimit me kusht. Kjo njihet si "dënim faktit ose për gjithë jetën". KPT-ja ka kritikuar vetë parimin e dënimeve të tilla në disa raporte vizitash, duke shprehur rezerva serioze për faktin se një i dënuar me burgim të përjetshëm konsiderohet një herë e mirë me qenë i rrezikshëm dhe privohet nga çdo shpresë për lirim me kusht (përveç me përjashtim të mëshirës ose të faljes).

Komisioni është i mendimit se të burgoset një person me jetë pa ndonjë perspektivë të vërtetë të liritimit është çnjerëzore. Ndërsa dënimi dhe mbrojtja publike janë elemente të rëndësishme të një dënimi me burg, duke përjashtuar që nga fillimi çdo shpresë për rehabilitimin dhe kthim në komunitet, e dehumanizon për rrjedhojë të burgosurin. Kjo nuk d.m.th. se të gjithë të burgosurit e përjetshëm duhet të lirohet herët a vonë; mbrojtja publike është çështje kyçe. Megjithatë, të gjitha dënimet e tilla duhet t’i nënshtrohen një shqyrtimi kuptimplotë dikur, bazuar në objektivat e individualizuar të planifikimit të dënimit të përcaktuara në fillim të dënimit dhe të rishikuara pastaj rregullisht. Kjo do të ofronte jo vetëm shpresë për të burgosurit, por edhe një objektiv për t’u synuar i cili do të duhej të motivonte sjellje pozitive. Kështu do t’i ndihmonte edhe administratat e burgjeve në trajtimin e individëve të cilët përndryshe nuk do të kishin shpresë as ndonjë gjë për të humbur. Ia vlen po ashtu të përmendet se edhe personat që dënohen nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (ose gjykatat speciale ndërkombëtare) për krimet më të rënda si gjenocidi, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, mund të përfitojnë në parim në një fazë të caktuar nga lirimi me kusht (i hershëm).

A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
<b>Po</b>	43
<b>Jo</b>	17

**Tabela nr.8 A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.**



**Grafikoni nr.8 A jeni të mendimit se duhet paraqitja e hartës institucionale që trajtojnë dënimin me burgim të përjetshëm dhe veprat e rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi.**


Sipas këtij grafikoni 72% e mbështesin pohojne kurse 28% mohojnë këtë mendim. Me pohimin e responentëve tanë aprovojmë edhe hipotezën e veçantë të këtij punimi.

A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
<b>Po</b>	48
<b>Jo</b>	12



**Tabela nr.9 A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.**



**Grafikoni nr.9 A jeni të mendimit se Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.**

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se 76% pohojnë kurse 24% mohojnë këtë mendim.

**❖ RAST STUDIMI KONKRET I DËNUAR NË BURGUN E IDRIZOVËS ME BURG  
TË PËRJETSHËM**

**DËNIMI ME BURG TË PËRJETSHËM**

**RASTI- VRASJE**

Janari i viti 2015 ishte, muaj mizor për një bashkëshorte.. Viktima në këtë rast ka qenë gruaja e tij. Personi me iniciale I.A nga Gjorçe Petrov i Shkupit ka vrare gruan e tij. Rasti i dhunës në familje që përfundoi me fatalitet, ishte të martën në Gjorçe Petrov ku një grua është vararë me armë zjarri, kurse i dyshuari kryesor është bashkëshorti i saj. Në anën tjetër, përfaqësues të shoqërisë civile theksojnë se, dhuna në familje , konkretisht vrasja e grave, është bërë fenomen shqetësues dhe alarmues për shoqërinë dhe autoritetet kompetente.

Sipas tyre, masat ndëshkuese ndaj kryerësve të këtyre veprave, janë ashpërsuar, mirëpo vrasjet nuk janë ndalur.

Gjykata e Apelit në Shkup ka vërtetuar dënimin me burgim të përjetshëm të Akuzuarit I.A i cili është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore për vrasjen e S.A 41 vjeçare tash më e ndjerë. I.A është dërguar menjehërë në burgun e Idrizovës ku atje vuan dënimin që 4 vite rradhazi. Sipas informata të sakta që vin nga ky burg i njëjti person ka desht që të vetvritet disa here duke provuar me varrje, therje të vetvetës dhe marrjen e dozave të larta të ilaçeve (barnave) të cilat pas një periudhe të gjatë i kuptuan se si depërtonin në këtë burg.

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si përfundim në hulumtimin e temës ZBATIMI I DËNIMIT ME BURGIM TË PËRJETSHËM NË R.MAQEDONISË mund të konstatoj se ky lloj dënimi është një dënim me të vjetra në botë poashtu ky lloj dënimi është një dënimet më të rënda që mund ti shqiptohet nga gjykata, kryeresit të veprës penale. Ky lloj i dënim shqiptohet për vepra më të rënda penale të përcaktuara me ligj kur plotësohen kushtet për shqiptimin e këtij dënimi të përcaktuar me ligj.

Trajtimi i këtij hulumtimi ishte mjaft kompleks, mjaft i ndërlikuar sepse zbatimi i këtij dënimi është mjaft kompleks dhe i ndërlikuar poashtu edhe reagimi ndaj çështjes së tillë është mjaft komplekse, ku hulumtimi i studimit në fjalë ka nevojë për qasje multidisiplinore sepse lidh dhe perfshin me shume aspekte, ku nga statistikat juridiket per zbatimin e këtij dënimi nuk është rrugë e vetme për të kuptuar përmasat e çështjes në fjalë sepse zbatimi i këtij dënimi ndaj personave të cilët janë kryerës të veprave më të rënda penale për të cilët shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi janë vetëm një pjesë e tyre sepse ndodh shpesh që persona të ndryshëm të cilët janë kryerës të veprave më të rënda penale të cilëve duhet tu shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi mirëpo për shkaqe dhe arsye të ndryshme këto persona nuk kapen dhe nuk u shqiptohet dhe zbatohet ky lloj dënimi.

Kuptimi më i plotë i çështja në fjalë gjithë aspekteve është kaq i rëndësishëm në trajtimin e këtij hulumtimi, ku çdo studim që i rreket të trajtojë çështjen në fjalë kontribon që të kemi kuptim për nocione kryesore dhe çëshjet kyçe të çështjes në fjalë si dhe kontribon në parandalimin e veprave të rënda penale për të cilat është paraparë ky lloj dënimi që mbarte sa ngarkese ligjore poashtu edhe ngarkese morale. Legjislacioni penal dhe ai proçedural penal vihen në mbrojtje të interesave të gjithë shoqërisë, nga këto legjislacione parashikohen veprat dhe sanksionet penale, rregullat proçeduriale të hetimit, gjykimit e dënimit të autorëve, ekzekutimit vendimeve penale, të drejtat e detyrimet e organeve dhe subjekteve proçeduriale penale.

Është detyrë kushtetuese e ligjore e organeve të ndjekjes penale, të cilat nën autoritetin dhe në emër të shtetit të luftojnë kriminalitetin, duke ushtruar ndjekjen penale ndaj autorëve të veprave penale në përputhje të plotë me Kushtetutën, me legjislacionin penal dhe me konventat ndërkombëtare në mbrojtje të drejtave e lirive themelore të individit.

Legjislacioni proçedural penal në vetvete përbëhet nga tëresia e gjithë rregullave proçeduriale që normojnë e rregullojnë gjithë proçesin penal, duke vendosur një ekuilibër sa më të drejtë midis

mbrojtës së interesave të shoqërisë duke luftuar me efektivitet kriminalitetin, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, zhvillimin e një procesi penal duke respektuar e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale është ai i “provave penale dhe procesit të provuarit” i cili me të drejtë është konsideruar si instituti bosht i kësaj të drejte. Rëndësia e provave penale dhe e procesit të provuarit përcaktohet nga vetë qëllimin dhe përmbajtja e legjislacionit penal. Instituti i provave penale dhe procesit të provuarit, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen dhe detyrën e kësaj shkence, me atë që quhet procesi i zbulimit dhe i të provuarit të së vërtetës në procesin penal.

Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar në ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtje shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në terheqjen e vërejtjes kryesit se do ti merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen vepra penale.

1. Sugjerohet më tepër bashkëpunim mes Institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, zyra vendore të shërbimit të provës, përmbarrimit gjyqësor, gjykatës dhe prokurorisë në moszvarritjen e proceseve gjyqësore kur gjykohen kërkesat e të dënuarve apo prokurorisë në fazën e ekzekutimit të vendimit penal për shkak të mosparaqitjes pa shkak të arsyeshëm të subjekteve procedurale, të dokumentacionit të ndodhur tek ta etj. Në këtë raste masat ndëshkuese të parashikuar në ligj ndaj këtyre institucioneve si gjobitja, do të disiplinonte palët dhe do të rriste përgjegjësinë e këtyre subjekteve të cilat kanë për detyrë të ekzekutojnë vendimet gjyqësore penale dhe jo të bëhen pengesë duke ulur në këtë mënyrë edhe besimin e qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë.

2. Të gjithë institucionet që marrin pjesë në ekzekutimet e vendimeve penale e sidomos kur veprimet e tyre janë me afat të përcaktuar në ligj duhet t'i zbatojnë ato korrektësisht duke i marrë si afate detyruese dhe jo si afate orientuese si p.sh afati 7 ditë për të gjykuar kërkesën për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, 5 ditë për të pezulluar ekzekutimin e urdhërit për punë në interes publik etj. Po ashtu edhe prokuroria dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të zbatoj afatet e tyre për të nxjerrë urdhërin për të ekzekutuar vendimet penale, për të pranuar të dënuarin në Institucion etj.

3. Proçedurat e ekzekutimit të vendimit penal sipas Opinionit nr.12 (2010) “Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore” të Këshillit konsultativ të gjyqtarëve europian të Këshillit të Europës duhet të orienton që ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale të mos jetë burokratik dhe me shpenzime të larta por me veprime sa më direkte të insitucioneve në zbatimin e këtyre vendimeve.

4. Mendoj se duhet të parashikohet në Kodin e Procedurës Penale ose në ligjin nr.8331/1998 rritje të kompetencave të gjykatës që të mbikqyrë zbatimin e vendimit penal qoftë edhe kryesisht dhe të mos presë në çdo rast që të investohet nga ana e të dënuarit apo të prokurorit, të krijohen mundësi që gjyqtari i ekzekutimit të vendimeve penale të bëj vizita periodike në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale që ndodhet në territorin e gjykatës ku të dënuarit të kenë kontakte drejtpërdrejtë me gjyqtarin, të shtohen mënyrë logjistike, kapacitete njerëzore për të monitoruar postën elektronike ose një numër pa pagesë (numër jeshil) për të dënuarit/ të paraburgosurit, të krijohen faqe zyrtare anonime të ankesave të të dënuarve për në Gjykatë për shkelje të të drejtave të tyre themelore gjatë kryerjes së burgimit ose gjatë paraburgimit etj.

5. Të publikohen periodikisht nga një organ i pavarur, si p.sh nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit, Avokati i Popullit një raport mbi efektivitetin e ekzekutimeve të vendimeve penale ose të krijohet një strategji kombëtare mes disa organeve shtetërore të përfshira në këtë lëndë si: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brëndëshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor etj. të arrijnë objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë etj. Në nëntor 2010 Këshilli Gjyqësor Kombëtar në Republikën e Kosovës publikoi Strategjinë shtetërore “Për zvoglimin e të lëndëve të vjetra të grumbulluara “ ku në një memorandum të përbashkët janë parashikuar detyrat e institucioneve të përfshira dhe çdo vit hartohet një raport mbi arritjet për të zvogluar dosjet e prapambetura civile, penale etj. të pa ekzekutuara e cila ka përmisuar situatën e ekzekutimeve të vendimeve penale të vonuara.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Ashworth. A., Drejt standardeve evropiane të dënimit, Revista Evropiane për Politika Penare dhe Huluntim, 1994
2. Departamenti i Drejtësisë, "Konsultimi mbi mekanizmin e udhëzuesit të dënimeve", 2010
3. Dr. Shefqet Muliqi, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2015
4. Françoise Tulkens, Negotiated Justice, European Criminal Procedures, (ed. Dalmans-Marty/ Spencer),
5. Franjo Bačić: Krivično pravo, opći dio, Informator, Zagreb 1995
6. Halleve, Gabriel. E drejta për t'u dënuar: dënimi modern doktrinal. Springer Science & Business Media, 2012.
7. Immanuel KANT, The Metaphysics of Morals, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar origjinal më 1779
8. Immanuel KANT, The Metaphysics of Morals, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar origjinal më 1779
9. Ismail Zejneli, E drejta penale, pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
10. Ismet Saliu. " E Drejta Penale", Prishtinë, 2005,
11. Ismet, Elezi Vrasjet për hakmarrje në Shqipëri, 2000
12. Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R(92)17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare Lidhur me Harmonizimin e Dënimeve, 19 tetor 1992.
13. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, Karta e Madhe e Gjyqtarëve, Parimet Themelore, Sundimi i Ligjit dhe Drejtësia, Strasburg, 17 nëntor 2010.
14. Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, The death Penalty For and against, publikuar nga Rowman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998
15. Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, The death Penalty For and against, publikuar nga Rowman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998
16. Peter HODGINSON dhe Andreë RUTHERFORD, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, Reflects on hanging, New York, Macmillan, 1957

17. Peter HODGINSON dhe Andrew RUTHERFORD, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, Reflects on hanging, New York, Macmillan, 1957
18. Peter HODGINSON dhe Andrew RUTHERFORD, Capital Punishment Global Issues and Prospects, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, Reflects on hanging, New York, Macmillan, 1957
19. Ragip Halili "Penologjia", Prishtinë, 2005
20. Rexhep Gashi, Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë, 2001
21. Vlado Kambovski. Kazneno pravo, Opsht del. Skopje, 2004
22. Vllado Kambovski, E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2016
23. Vllado.K&Ismail.Z, E drejta penale,Pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018
24. W. & M. ch. 2 (1688) (Eng.); see also Anthony F. Granucci, "Nor Cruel and Unusual Punishments Inflicted": The Original Meaning, 57 CAL. L. REV. 839, 839 (1969) (noting that English Bill of Rights of 1689 prohibits cruel and unusual punishments).
25. William A Schabas, The Abolition of the Death Penalty in International Laë (Third Edition: Cambridge UP, 2002)
26. Zekir Sulejmanov: Penologija, Shkup, 2000,

## Burime shitesë

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950), Neni 6, 'E drejta në gjykim të drejtë
2. Raporti për vitin 2012 i Amnesty Internacional, f. 34-35, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/ACT50/001/2013/en/bbfea0d6-39b2-4e5f->
3. Abolitionist and retentionist countries, Amnesty International, <http://www.amnesty.org/en/deathpenalty/abolitionist-and-retentionist-countries>, qasur më 09 gusht 2013
4. Statistika të dënimit me vdekje <http://www.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 9 gusht 2013

5. Intervistë në CNN me Damian Echoles, i cili është duke pritur ekzekutimin, pasi që u dënua me vdekje që nga viti 1993
6. Shpenzimet e ekzekutimit të Timothy McVeigh
7. <http://www.guardian.co.uk/world/2001/jun/30/mcveigh.usa>, qasur më 09 gusht 2013.
8. Costs on Death Penalty, Death Penalty Information Center, New York
9. <http://www.deathpenaltyinfo.org/costs-death-penalty#FromDPIC>, qasur më 09 gusht 2013.

## Ligje

1. Kodi Penal i Maqedonisë
2. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në Maqedoni
3. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë
4. Ligji mbi të drejtat e personave të dënuar në Shqipëri